



**KOLEGJI UNIVERSITAR**  
**“WISDOM”**

---

Adresa: Rruga Fuat Toptani, godina 54, Tiranë, Shqipëri [www.wisdom.edu.al](http://www.wisdom.edu.al), tel: 042200063; cel: 0676022736

**STATUTI**  
**I**  
**KOLEGJI UNIVERSITAR “WISDOM”<sup>1</sup>**

**Hyrja**

Kolegji Universitar “Wisdom”, ish Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University” është krijuar nga shoqëria “Wisdom”sh.p.k.mbi bazën e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.672, datë 27.09.2006. Ndërsa me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.254, datë 27.02.2008, është dhënë leja për zhvillimin e programeve të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë në Fakultetin e Drejtësisë dhe atë të Psikologjisë. Me Urdhër Nr.412 datë 25.08.2011 të Ministrit të MASH është miratuar riorganizimi i Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University” me dy fakultete, Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike e Shoqërore. Me Urdhër Nr.355, datë 25.10.2015 të Ministrit të MAS është bërë Akreditimi Institucional i saj.

Mbështetur në nenin 20, 33 dhe 129 të Ligjit Nr. 80/2015“Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Senati Akademik me Vendimin Nr. 6, datë 03.02.2017 vendosi riorganizimin e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University”. Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University” u kthye në Kolegj Universitar, me emërtimin **KOLEGJI UNIVERSITAR “WISDOM”**.

Statuti përmban norma që burojnë nga neni 57, pika 7 e Kushtetutës rregullojë veprimtarinë e Kolegji Universitar “Wisdom” në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe

---

<sup>1</sup> Miratuar me Urdhër Nr.145, datë 31.03.2017 të Ministrit, të MAS-it, me Urdhër Nr.459, date 22.11.2021 dhe Urdhër 674, date 07.11.2022 “Për miratim e një ndryshimi në Statutin e KU “Wisdom”

Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve të tjera nënligjore, duke garantuar parimin e lirisë akademike dhe autonomisë universitare.

Statuti u miratua me Vendimin Nr.7, datë 03.02.2017 të Senatit Akademik dhe Vendim Nr.4, datë 31.01.2017 të Bordit të Administrimit.

## **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1**

#### **Emri**

Kolegji Universitar “Wisdom” është institucion i arsimit të lartë që vepron në fushën e drejtësisë, ekonomisë dhe të shkencave shoqërore, si dhe të kërkimit shkencor bazë dhe të zbatuar, veprimtari krijuese, shërbime, etj., dhe do të ketë emrin zyrtar **Kolegji Universitar “Wisdom” (KU “Wisdom”)**

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet e termave**

Në Statut termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. *Kolegji Universitar “Wisdom” (KU “Wisdom”)* i licencuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.254, datë 27.02.2008, akredituar me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportëve Nr.355, datë 25.10.2015.
2. *Studenti/tja*, është ai subjekti që ka lidhur kontratën e regjistrimit me Kolegjin Universitar “Wisdom” dhe është pajisur me numrin e veçantë të matrikullimit të lëshuar nga AKP.
3. *Viti Akademik* është periudha kohore e zhvillimit të procesit mësimor, e organizuar në semestra, e cila fillon çdo tetor dhe përfundon në shtator të vitit pasardhës.
4. *Tarifat* janë pagesa e shkollimit si dhe pagesa të tjera shtesë që nevojiten për rifrekuentim lëndësh, për provime, etj.; sipas parashikimeve të kontratës së lidhur ndërmjet Studentit dhe Kolegji Universitar “Wisdom”, etj.
5. *Regjistrimi* është nënshkrimi i kontratës për ndjekjen e studimeve nga studentit në KU “Wisdom”, kryerja e pagesës, regjistri në amzën e Kolegji Universitar “Wisdom” dhe lëshimi i Kartës së Studentit.
6. *Studimet e ciklit të parë* japin njohuri bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe fiton aftësi specifike në një fushë të caktuar profesionale dhe specialitetesh. Studimet në këtë cikël realizohen me 180 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tre) vite akademike. Në përfundim të studimeve të ciklit të parë lëshohet diplomë “Bachelor” në fushën përkatëse.

7. *Studimet e Ciklit të dytë* bazohen në programet “Master i Shkencave” dhe japin njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim në kërkimin e pavarur në një fushë brenda një specialiteti. Studimet realizohen me të paktën 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 (dy) vite akademike. Në përfundim të programeve lëshohet diplomë “Master i Shkencave”.

8. *Programet e integruara* të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë realizohen me 300 kredite, për një kohëzgjatje prej jo më pak se 5 vite akademike.

### **Neni 3**

#### **Objekti**

Kolegji Universitar “Wisdom” është institucion i arsimit të lartë që vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale. Objekti i Kolegji Universitar “Wisdom” është përgatitja e specialistëve të lartë në fushën e shkencave juridike, shkencave ekonomike dhe atyre psikologjike e sociale, të ciklit të parë, dhe me orientim profesional e formim shkencor të ciklit të dytë dhe të studimeve të integruara në drejtësi.

### **Neni 4**

#### **Misioni dhe qëllimi**

1. Kolegji Universitar “Wisdom” është një institucion jopublik që garanton liri akademike, respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, në këtë Statut, si dhe aktet që janë të detyrueshme përgjithësisht për institucionet e arsimit të lartë.

2. Kolegji Universitar “Wisdom” ka për mision zhvillimin e arsimit dhe shkencës, në shërbim të lirisë e diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor, për zhvillimin e ekonomisë, për rritjen e mirëqenies e dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente.

3. Kolegji Universitar “Wisdom” garanton shprehjen e lirë të ideve shkencore, kulturore, politike, sindikale e fetare, duke mos lejuar hallka organizative e aktivitete të partive politike e komuniteteve fetare, përveç atyre me karakter shkencor e arsimor. Traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, janë baza e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të ndërthurura me standardet dhe arritjet më të mira botërore përgjithësisht e ato evropiane, në veçanti.

4. Kolegji Universitar “Wisdom” ka për qëllim t’u japë studentëve një edukim cilësor, duke integruar rezultatet e një kërkimi shkencor të vlefshëm, që t’i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, përdorimit të arritjeve më të mira të shkencës, si dhe partneriteteve me tregun e punës e atyre ndërkombëtare.

5. Të jetë një qendër për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare, një qendër ekselence në formimin akademik të studentëve tanë, një qendër ekspertize të specializuar në fushën e studimeve juridike, shoqërore dhe ekonomike, si dhe një qendër ekselence për kërkimin shkencor bazë dhe të zbatuar.

6. Kolegji Universitar “Wisdom” ka për qëllim:

- Të ofrojë studime të plota universitare të ciklit të parë, të ciklit të dytë, studime të integruara në drejtësi dhe veprimtari mësimore e trajnuese profesionale, në përputhje me Kartën e Bolonjës dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- Të kryejë studime dhe kërkime shkencore në fushën e shkencave juridike, ekonomike dhe të psikologjisë dhe jo vetëm.
- Të kryejë kualifikimin shkencor pasuniversitar, kurse të specializimit dhe kurse të kualifikimit afatshkurtër dhe afatgjatë për juristë, psikologë, ekonomistë dhe persona të fushave të tjera në programe studimi ndërdisiplinorë.
- Të sigurojë cilësi të lartë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, duke zbatuar metoda të avancuara e moderne të mësimdhënies, ndër të tjera nëpërmjet nxitjes së të mësuarit aktiv, duke përdorur teknika, materiale dhe përvoja të universiteteve të zhvilluara perëndimore dhe nëpërmjet zbatimit të kriterëve më të larta të mësimdhënies dhe mësimnxënies për stafin akademik dhe për studentët.
- Të caktojë objektiva të qarta për çdo program, se çfarë duhet të dijë dhe çfarë do të jetë në gjendje të bëjë pas përfundimit të programit.
- Të vendosë një lidhje të fortë dhe funksionale me komunitetin në përgjithësi dhe veçanërisht me administratën shtetërore dhe komunitetin e biznesit nëpërmjet arritjes së një partneriteti të përhershëm shumë funksional etj.

7. Për arritjen e misionit dhe qëllimit Kolegji Universitar “Wisdom” ka këto objektiva:

- Arritjen e cilësisë së lartë në të gjitha fushat e aktiviteteve akademike dhe të kërkimit shkencor;
- Mbajtjen e një stafi akademik të shquar me vlera dhe aftësi të larta profesionale;
- Cilësinë e lartë në proceset akademike dhe të infrastrukturës së institucionit;
- Pajisjen e studentëve të diplomuar me edukimin më të mirë dhe mundësi që ata të rrisin dijet në vazhdimësi;
- Ndërtimin e urave të bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
- Krijimin e një mjedisi nxitës e zhvillues për stafin akademik, punonjësit dhe studentët;

## **Neni 5**

### **Parimet**

1. Kolegji Universitar “Wisdom” respekton liritë akademike të të dyja palëve: të trupit akademik në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor dhe të komunitetit të studentëve në mësimnxënie, në kuptimin që shpreh Ligji Nr.80/2015 *“Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”*, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, duke përfshirë ato ndërkombëtare që janë të zbatueshme në RSH.

2. Veprimtaria e Kolegjit Universitar “Wisdom” me studentët, trupin akademik dhe stafin administrativ mbështetet në meritat personale dhe përjashton çfarëdoj diskriminimi në të gjitha format që ai mund të shfaqet.

3. Pedagogëve dhe punonjësve shkencorë u garantohet autonomia dhe liria e mësimdhënies dhe kërkimit në harmoni, pa e penguar realizimin e programeve e objektivave të miratuara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozitat e këtij Statuti.

4. Mundësia e barabartë për kushtet materiale dhe financim të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor është kriteri themelor në veprimtarinë pedagogjike e kërkimore. Mbështetja për diferencime individuale ose grupe, është përjashtim që lejohet nga organi kompetent në mënyrën e përcaktuar në ligj e në Rregulloren e Kolegji Universitar “Wisdom”, për objektiva të një rëndësie të veçantë, për raste emergjente, për shkak të detyrimeve ndërkombëtare ose në mbështetje të talenteve.

5. Kolegji Universitar “Wisdom” konsideron detyrë themelore të mësuarit, studimin dhe kërkimin shkencor në bashkëpunim me institucionet vendase dhe nëpërmjet shkëmbimit kombëtar dhe ndërkombëtar të pedagogëve e studentëve, në përmbushje të objektivave dhe programeve të tij.

6. Kolegji Universitar “Wisdom” u krijon studentëve kushtet për përvetësimin e dijeve, shprehjen e lirë të mendimit e të organizimit në respektim të kërkesave të bashkëjetesës, të ligjit Statutit dhe Rregullore së tij. Veprimtaritë dhe aktivitetet në grup me karakter kulturor, shkencor e sportiv, realizohen në përputhje me Rregulloren e Kolegji Universitar, duke respektuar kërkesat ligjore për veprimtari të tilla.

## **Neni 6**

### **Themelimi**

1. Kolegji Universitar “Wisdom” është vazhdim i Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University”, themeluar nga shoqëria “Wisdom” sh.p.k. e njohur me vendimin Nr. 14905, datë 17.05.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.672, datë 27.09.2006, me të cilin është dhënë leja për studimin në distancë në degët shkenca bankare dhe të sigurimeve dhe shkenca politike, si dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.254, datë 27.02.2008, është dhënë leja për zhvillimin e programeve të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë në fakultetin e drejtësisë dhe atë të psikologjisë. Me Urdhër Nr.412 datë 25.08.2011 të Ministrit të MASH është miratuar riorganizimi i Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University” me dy fakultete, Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike e Shoqërore. Me Urdhër Nr.355, datë 25.10.2015 të Ministrit të MAS është bërë akreditimi institucional i saj.

2. Me Vendim Nr. 6, datë 03.02.2017 të Senatit Akademik bëhet riorganizimi i Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University”, duke u kthyer në Kolegji Universitar, sipas nenit 20, të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, me emërtimin ***Kolegji Universitar “Wisdom”***.

## **Neni 7**

### **Përfundimi i studimeve**

Përfundimi i çdo programi studimi, vërtetohet me diploma, dëshmi e certifikata përkatëse në përputhje me llojin dhe nivelin e formimit sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore dhe rregullores së Ku “Wisdom”. Përmbajtja dhe formatet e të cilave miratohen nga Senati Akademik dhe regjistrohen në MAS në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

## **Neni 8**

### **Të drejtat e Kolegjit Universitar “Wisdom”**

Në zbatim të autonomisë institucionale dhe lirisë akademike Kolegji Universitar “Wisdom” ka të drejtë:

- a) Të zgjedhë lirisht strukturën institucionale të Kolegjit Universitar “Wisdom”, autoritetet dhe organet e veta drejtuese sipas këtij Statuti deri në nivel departamenti/grup lëndësh; të përzgjedhë personelin akademik, personelin ndihmës akademik dhe personelin administrativ, gjithmonë në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.
- b) Të zgjedhë lirisht programet e studimit që do të ofrojë në institucion përkundrejt plotësisht të standardeve akademike respektive; të miratojë plane, programe mësimore dhe të kërkimit shkencor, tekste në përdorim të studentëve të tij, si dhe literaturën përkatëse; të përcaktojë, nëse e vlerëson të arsyeshme, kritere të veçanta për çdo program studimi, si kusht për pranimin e studentëve në to, për çdo vit akademik; të përcaktojë procedurat dhe kriteret për dhënien e bursave të studimit.
- c) Të përcaktojë fushat e kërkimit shkencor dhe të zhvillojë programin e tij me orientim të gjerë evropian dhe ndërkombëtar;
- d) Të krijojë lidhje bashkëpunimi me struktura universitare, të ngjashme ose të përafërta, të arsimit të lartë ose të kërkimit shkencor brenda ose jashtë vendit që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e arsimit të lartë; të anëtarësohet në shoqata e organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë publik ose privat;
- e) Të ofrojë shërbime në fushat që kanë lidhje me zbatimin praktik të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe këtë Statut;
- f) Të pranojë donacione nga fondacione vendase e të huaja që ndihmojnë zhvillimin e Arsimit të Lartë;
- g) Të përdorë tokën, ndërtesat dhe pasuritë e tjera që zotëron ose që ka në qiramarrje për qëllime të arsimit, ose që lidhen me të, si dhe çdo lloj pasurie tjetër sipas legjislacionit në fuqi.

## **Neni 9**

### **Paprekshmëria**

1. Të gjitha mjediset e Kolegjit Universitar “Wisdom” gëzojnë paprekshmërinë që u garanton Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” institucioneve të arsimit të lartë.

2. Ndërhyrja e organeve të policisë në mjediset akademike bëhet vetëm në rastet e parashikuara

nga legjislacioni në fuqi, në rastet e nevojës ekstreme, dhe me kërkesën dhe/ose lejen e Rektorit ose të personave të autorizuar nga ai.

## **Neni 10**

### **Detyrimet e Kolegjit Universitar “Wisdom”**

Kolegji Universitar “Wisdom” ka për detyrë:

- a) Të zhvillojë procesin mësimor si dhe atë kërkimor e shkencor sipas standardeve shtetërore të përcaktuara dhe në përputhje me normat dhe standardet bashkëkohore;
- b) Të respektojë angazhimet e ndërmarra që burojnë nga kontratat me studentët dhe pedagogët;
- c) Kolegji Universitar “Wisdom” është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë.
- d) Të raportojë në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës për veprimtarinë mësimore–shkencore sipas parashikimeve ligjore;
- e) T’u nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit të programeve të studimit dhe atij institucional;
- f) Të bëjë publike programet e studimit që ofron sipas niveleve, kuotat dhe kriteret e studimit;
- g) Të bëjë të njohur publikisht raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë;
- h) Të paraqesë çdo fillim viti akademik gjendjen financiare të institucionit, përbërjen e stafit akademik, si dhe tarifat e shkollimit për vitin në vazhdim, për secilin program studimi.

## **Neni 11**

### **Sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë**

1. Sigurimi i brendshëm i cilësisë është vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të Kolegjit Universitar “Wisdom”. Ky vlerësim kryhet të paktën 1 (një) herë në 6 (gjashtë) vjet, por gjithashtu mund të kryhet sa herë shihet e arsyeshme, si vlerësim i përgjithshëm ose i pjesshëm.
2. Sigurimi i brendshëm i cilësisë realizohet nga vetë institucioni nëpërmjet:
  - a) Strukturave hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të Kolegjit Universitar “Wisdom”, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të tij.
  - b) Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila vlerëson efikasitetin e veprimtarive akademike, administrative dhe financiare të Kolegjit Universitar “Wisdom” dhe harton raportin përkatës të Vlerësimit të Brendshëm (RVB). Ky raport diskutohet në të gjitha njësitë e Kolegjit Universitar “Wisdom”, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen.
3. Struktura dhe funksionimi i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përcaktohen në dispozitat në vazhdim dhe në rregulloren e Njësisë Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
4. Sigurimi i jashtëm i cilësisë kryhet nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë ose agjenci të tjera të autorizuar, me kërkesë të rektorit të institucionit, pas përfundimit të raportit të vlerësimit të brendshëm.

## **KREU II**

### **ORGANIZIMI AKADEMIK**

#### **Neni 12**

##### **Struktura e KU “Wisdom”**

1. Kolegji Universitar “Wisdom” përbëhet nga struktura akademike dhe struktura administrative, sipas shtojcës nr.1 bashkëlidhur këtij statuti, e cila është pjesë përbërëse e statutit të KU “Wisdom”. Organi më i lartë drejtues akademik është Senati Akademik. Organi më i lartë drejtues administrativ është Bordi i Administrativ.
2. Autoritetet drejtuese akademike janë rektori, drejtuesi i njësisë kryesore dhe drejtuesi i njësisë bazë. Organe të tjera akademike janë asambleja e personelit akademik dhe komisionet e përhershme. Autoritetet drejtuese administrative janë: administratori i institucionit dhe administratori i njësisë kryesore.
3. Organe kolegjiale të tjera janë: rektorati, dekanati, këshilli i etikës.

#### **Neni 13**

##### **Struktura akademike**

1. Kolegji Universitar “Wisdom” përbëhet nga tre njësi kryesore, të strukturuar në përputhje me nenin 22 të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”
2. Struktura akademike e Kolegjit Universitar “Wisdom”, është:
  - Senati Akademik
  - Rektori
  - Rektorati
  - Këshilli i Etikës
  - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
  - Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë
  - Komisioni për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe kurrikulën
  - Komisioni për marrëdhëniet me studentët, publikun dhe koordinimin.

##### **Fakulteti i Drejtësisë** me tre njësi bazë:

- 1) Departamenti i të Drejtës Publike dhe Evropiane
- 2) Departamenti i të Drejtës Private
- 3) Departamenti i të Drejtës Penale

##### **Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore** me tre njësi bazë:

- 1) Departamenti i Shkencave ekonomike
- 2) Departamenti i Shkencave të Arsimit
- 3) Departamenti i Psikologjisë



## **Neni 14**

### **Senati Akademik dhe organizimi i tij**

1. Senati Akademik është organi më i lartë drejtues akademik i Kolegjit Universitar “Wisdom“, përgjegjës për përmbushjen e misionit dhe qëllimit të tij.
2. Senati kryesohet nga rektori dhe mbledhet periodikisht, si rregull mbledhet një herë në 3 (tre) muaj, por jo më pak se 3 (tre) herë në vit. Anëtarët e Senatit Akademik i përkasin kategorisë “Profesor” ose kanë gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së, në mungesë të autoriteteve drejtuese me këtë titull dhe, për efekt të përfaqësimit, kategoria e tyre mund të zbresë në “Doktor”.
3. Senati Akademik përbëhet nga 13 anëtarë me të drejtë vote. 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë zgjidhen nga stafi akademik, me kohë të plotë, me vetëkandidim, dhe 2 (dy) anëtarë zgjidhen nga komuniteti i studentëve.
  2. Anëtarët e Senatit Akademik zgjidhen nga Asambleja e Personelit Akademik të Fakultetit të Drejtësisë dhe të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, përmes një votimi të përgjithshëm, për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, midis anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë të vetëkandiduar. Studentët përfaqësohen në Senat në masën rreth 15%.
3. Mandati i anëtarit të Senatit Akademik merr fund:
  - me mbarimin e afatit;
  - me dorëheqje;
  - kur ndërpret marrëdhëniet pedagogjike, studimore apo të punës me Kolegjin Universitar “Wisdom”;
  - kur mungon pa arsye në 4 seanca radhazi mbledhjesh të tij.
4. Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për Senatit Akademik. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të zgjedhur të Senatit Akademik. Zëvendësimi brenda mandatit i një anëtari të Senatit bëhet me miratimin e shumicës së anëtarëve të tij.
5. Rektori është anëtar dhe kryetar i Senatit për shkak të detyrës dhe përfaqësues i tij. Me propozim të Rektorit, kur nuk ka zëvendësrektor, Senati Akademik zgjedh nga anëtarët e tij një nënkryetar.
6. Si organ vendimor, Senati merr vendime me shumicë absolute votash. Vendimet e tij Senati i bën të njohura nëpërmjet Rektorit. Rendi i ditës zakonisht propozohet nga Rektori dhe miratohet nga Senati. Senati mund të mbledhet gjithashtu në seanca të jashtëzakonshme me thirrjen e Rektorit ose kur këtë e kërkon 1/3 e anëtarëve me të drejtë vote.

## **Neni 15**

### **Funksionet e Senatit**

1. Funksionet e Senatit Akademik burojnë nga neni 38 i Ligjit Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë

dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

2.Senati akademik është organ kolegjal vendimmarrës i Kolegjit Universitar “Wisdom” që përcakton politikat e zhvillimit të institucionit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre. Senati akademik kryesohet nga rektori dhe mbledhet periodikisht.

3. Funksionet e Senatit Akademik janë:

- a) garanton autonominë e Kolegjit Universitar “Wisdom”, lirinë akademike dhe mundësi të barabarta, si dhe të drejtat e studentëve;
- b) propozon planin strategjik të zhvillimit të Kolegjit Universitar “Wisdom”;
- c) miraton statutin e Kolegjit Universitar “Wisdom”, me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit dhe miraton rregulloret e institucionit;
- d) harton strukturën e përgjithshme të institucionit të arsimit të lartë dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet;
- e) miraton programet e reja të studimit, të kërkimit shkencor, ndryshimet si dhe mbylljen e tyre, duke garantuar mbështetjen financiare në projektbuxhetin vjetor të institucionit;
- f) propozon mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
- g) miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive të Kolegjit Universitar “Wisdom”, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë. Në këto raste merr vlerësimin paraprak edhe të Bordit të Administrimit;
- h) miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore dhe miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati, dhe ia përcjell atë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- i) miraton paraprakisht planin buxhetor vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit;
- j) krijon Komisionin e Përhershëm për vlerësimin e personelit akademik dhe komisione të tjera;
- k) garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në Kolegjin Universitar “Wisdom” duke krijuar mekanizmat për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe mban përgjegjësi për sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion, në përputhje me standardet shtetërore;
- l) vlerëson dhe miraton programet e reja të studimit, të kërkimit e zhvillimit apo pjesë të tyre si dhe hapjen, ndryshimin ose mbylljen e njësive mësimore ose kërkimore;
- m) vlerëson veprimtarinë mësimore-kërkimore të personelit akademik;
- n) siguron që kryerja dhe vlerësimi i të gjitha provimeve të bëhet në përputhje me standardet e institucionit, që garantojnë cilësinë, objektivitetin dhe transparencën e duhur.
- o) Miraton kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për studentë, sipas propozimeve të njësive kryesore dhe kuotat e pranimit për çdo vit akademik.
- p) Miraton rastet e trajtimit të posaçëm të pedagogëve, studiuesve dhe studentëve me aftësi e rezultate veçanërisht të larta e të rëndësishme.

- q) Përzgjedh anëtarët e Këshillit të Etikës, të Njësisë Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe të komisioneve të përhershme.
- r) Miraton në shkallë të dytë planet mësimore dhe ato kërkimore-shkencore të fakulteteve;
- s) Përcakton normat vjetore të ngarkesës minimale mësimore dhe kërkimore - shkencore për personelin akademik të brendshëm;
- t) Miraton rregullat, procedurat dhe programet e kualifikimit pasuniversitar;
- u) Rekomandon dhënien e çmimeve të veçanta, të titujve dhe nderimeve të tjera të Kolegjit Universitar “Wisdom”;
- v) Shqyrton dhe jep mendim për ndryshime dhe rregullime të nivelit të pagesave për pedagogët e brendshëm dhe të nivelit të honorarëve për pedagogët e jashtëm brenda buxhetit vjetor të miratuar.
- w) Ushtron çdo kompetencë tjetër që me ligj ose me këtë Statut nuk i është dhënë ndonjë organi tjetër, duke përjashtuar çështjet që kanë të bëjnë me administrimin financiar të cilat i janë dhënë Bordit të Administrimit.

4. Me ankim, me kërkesë apo kryesisht, shqyrton ligjshmërinë e akteve të njësive kryesore. Kur konstaton se ato vijnë ndesh me ligjin dhe statutin, ia kthen për shqyrtim dekanit me sugjerimet përkatëse. Nëse njësia kryesore përsëri merr vendim në kundërshtim me aktet normative në fuqi, Senati Akademik vendos ndryshimin ose shfuqizimin e tij.

5. Miraton hapjen e degëve, krijimin e qendrave apo kurseve të posaçme, si dhe projekteve të tjera të shërbimit, bazuar në propozimin e njësive kryesore ose atyre bazë si dhe ristrukturimin e Kolegjit Universitar “Wisdom”.

6. Nëpërmjet Rektorit, Senati i propozon Bordit:

- qëllime, politika dhe veprime që u shërbejnë interesave më të mira të komunitetit dhe të Kolegjit Universitar “Wisdom”;
- politika konkrete të mësimdhënies dhe rekrutimit të trupit akademik, programe jashtë-mësimore të kërkimit, botime mësimore-shkencore, trajnime të ndryshme, kriteret e dhënies së granteve apo bursave të veçanta (brenda buxhetit të miratuar), etj.;

## **Neni 16**

### **Rektori**

1. Rektori është autoriteti më i lartë akademik i Kolegjit Universitar “Wisdom”, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare.

2. Rektori i Kolegjit Universitar “Wisdom” mban titullin “Profesor” dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit ose dhe jashtë tij. Rektori drejton Senatin Akademik dhe raporton para tij.

3. Rektori emërohet nga asambleja e ortakëve të shoqërisë me propozim të Senatit Akademik të Kolegjit Universitar “Wisdom”.

4. Mandati i rektorit zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit, ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.

5. Rektori shkarkohet në rastet e kryerjes së veprave penale me dashje ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën, të mos përmbushjes së rregullt të detyrës, për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së institucionit.

## **Neni 17**

### **Funksionet e Rektorit**

Rektori, është autoriteti më i lartë drejtues, ekzekutiv e urdhërdhënës i Kolegjit Universitar “Wisdom”, i cili, veç sa parashikohet në ligj, ka edhe këto funksione:

- a) Siguron zbatimin e vendimeve, masave dhe kërkesave të Senatit Akademik dhe Bordit.
- b) Kur i kërkohet ose me iniciativën e tij, merr pjesë pa të drejtë vote në mbledhjet e organeve dhe njësive përbërëse të Kolegjit Universitar “Wisdom” në të cilat nuk bën pjesë ligjërisht ose sipas këtij Statuti.
- c) Kryeson mbledhjet e Senatit Akademik dhe përfaqëson Kolegjin Universitar “Wisdom” në marrëdhënie me organet e institucionet shtetërore dhe të tretët.
- d) Paraqet propozimet për aktet që janë në kompetencë të Senatit Akademik dhe Bordit.
- e) I kërkon informacion Bordit të Administrimit për çështje të kompetencës së tij.
- f) Shfuqizon, kryesisht apo me kërkesë të të interesuarit, aktet e dekanit kur bien ndesh me legjislacionin në fuqi, me këtë Statut dhe me aktet e tjera të miratuara në bazë dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe këtij Statuti.
- g) Nënshkruan diplomat e ciklit të parë dhe të dytë, pa të drejtë për ta deleguar nënshkrimin.
- h) Nënshkruan marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.
- i) Zgjidh çështjet e kompetencës mes organeve dhe drejtuesve të njësive, përveç atyre mes Senatit Akademik dhe Bordit. Zgjidh mosmarrëveshjet midis strukturave të ndryshme të Kolegjit Universitar.
- j) Organizon ose ushtron kontrolle në fakultete për cilësinë e mësimdhënies, administrimin e buxhetit, kërkimin shkencor, si dhe çdo çështje tjetër që kanë në kompetencë këto të fundit.
- k) Ngre komisione e grupe pune për çështje, studime dhe veprimtari të veçanta.
- l) Merr masa për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit në kohë dhe sipas kërkesave ligjore.
- m) I propozon Senatit krijimin, shkrirjen ose ndryshimin e një strukture, të një shërbimi ose të një njësie mësimore-shkencore ose administrative;
- n) Pas këshillimit me Senatin, i propozon bordit të administrimit, brenda buxhetit vjetor të miratuar, ndryshime dhe rregullime të domosdoshme të nivelit të pagesave të pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm;
- o) I propozon Senatit Akademik dhe Bordit politika konkrete të mësimdhënies dhe rekrutimit të trupit akademik, programe jashtë mësimorë të kërkimit, botime mësimore-shkencore, trajnime të ndryshme, kritere të dhënies së granteve apo bursave të veçanta (brenda buxhetit të miratuar), etj.;

- p) Me miratim të Senatit jep çmime të veçanta, tituj apo vlerësime të tjera;
- q) Me propozim të dekanit, miraton Komisionin e Vlerësimit të pedagogëve dhe punonjësve kërkimorë-shkencorë;
- r) Emëron dekanët e fakulteteve, dhe zv/rektorin, pasi ka marrë mendimin e senatit akademik dhe administratorit të shoqërisë;
- s) Emëron personelin akademik me kohë të plotë të propozuar nga drejtuesi i njësisë kryesore, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 64 të Ligjit 80/2015 dhe nenin 21 dhe 45 të këtij Statuti;
- t) Rektori nënshkruan kontratat e punës të personelit akademik dhe ndihmës akademik në institucionet e arsimit të lartë.
- u) Vendos procedura që udhëheqin veprimtarinë për të grumbulluar fonde dhe prioritete për Kolegjin Universitar “Wisdom”;
- v) Shqyrton ankimin e studentit kundër masës së përjashtimit nga Kolegji Universitar “Wisdom” dhe vendos përfundimisht për të. Në bashkëpunim me dekanin përkatës vendos për përjashtimin e studentëve nga Kolegji Universitar “Wisdom”;
- w) Jep leje për hyrjen e forcave të rendit në mjediset e Kolegjit Universitar “Wisdom” dhe mund t’i thërrasë ato në rast nevoje;
- x) Urdhëron regjistrimin me transferim të studentëve si dhe transferimin e tyre në institucione të tjera.
- y) Rektori në mungesë të tij mund të autorizojë një nga autoritetet drejtuese të KU “Wisdom” për ta zëvendësuar.
- z) Marrëdhëniet e Rektorit me organet e tjera, mënyra dhe kushtet e ushtrimit të kompetencave të tij parashikohen në rregulloren e Kolegjit Universitar “Wisdom”.

## **Neni 18**

### **Rektorati**

1. Rektorati i Kolegjit Universitar “Wisdom” është krijuar sipas nenit 40, pika 1 e Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Rektorati është organ kolegjal që drejtohet nga rektori dhe përbëhet nga:

- a) rektori;
- b) zëvendës rektori/ia;
- c) administratori i institucionit;
- ç) drejtuesit e njësive kryesore.

2. Rektorati harton planin strategjik të zhvillimit të institucionit, mbështetur në propozimet e njësive bazë dhe kryesore të institucionit, si dhe ato të administratorëve.

3. Rektorati si organ kolegjal funksionon me mbledhje. Vendimet merren në mbledhje të organizuara rregullisht me tematikë të paracaktuar e të njoftuar të paktën dy ditë para mbledhjes. Në raste urgjente, tematika komunikohet në fillim të mbledhjes.

3. Mbledhja e Rektoratit kryesohet nga Rektori dhe është e vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 2/3 e tij. Në mungesë të Rektorit dhe autorizim të posaçëm të tij, mbledhjen mund ta drejtojë një nga anëtarët e tij i caktuar nga rektori.

## **Neni 19**

### **Funksionet e rektoratit**

1.Rektorati, përveç misionit, të drejtave dhe detyrave të përcaktuara nga ligji, ka edhe këto kompetenca:

- Ofron infrastrukturën dhe shërbimin administrativ për mbarëvajtjen e funksionimit të organeve dhe autoriteteve drejtuese të Kolegjit Universitar “Wisdom”.
- Ushtron në njësitë e Kolegjit Universitar “Wisdom” kontrolle tematike ose për aspekte konkrete, të njoftuara paraprakisht ose jo, për përmbushjen e detyrave dhe qëllimeve të tyre, si dhe për zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, të Statutit, Rregullores dhe akteve të organeve dhe autoriteteve drejtuese të Kolegjit Universitar “Wisdom”.
- Ka të drejtë të lëshojë urdhra dhe udhëzime për të gjitha strukturat përbërëse të Kolegjit Universitar “Wisdom”.
- Jep rekomandime dhe opinione për strukturat drejtuese të Kolegjit Universitar “Wisdom” për probleme të cilat ai i vlerëson apo i kërkohet, në ushtrimin e funksioneve të këtyre strukturave.
- Jep opinionin e tij kur kjo kërkohet nga Rektori, për çështje që lidhen me konflikte midis strukturave të Kolegjit Universitar “Wisdom” sipas kompetencave që ligji i njeh Rektorit.

2. Në varësi të strukturës dhe organikës së Rektoratit, miratohet rregullorja e Rektoratit, në të cilën përfshihen përshkrimet e punës të secilit punonjës, me përjashtim të atyre punonjësve që i kanë të përcaktuara ato në akte të tjera.

3. Veç sa parashikohet nga ligji dhe në këtë Statut, organizimi dhe funksionimi i Rektoratit kryhet në realizim të detyrave dhe objektivave që i njeh ligji për arsimin e lartë, në mënyrën që përcaktohet në Rregulloren e punës e cila propozohet nga Rektorati dhe miratohet nga Senati Akademik.

## **Neni 20**

### **Zëvendës rektori**

1. Zv. Rektori emërohet nga Rektori pas miratimit në senatit akademik dhe pëlqimin e administratorit të shoqërisë dhe duhet ti përkasë kategorisë “Profesor” ose ka gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Ata janë anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë. Zëvendës rektori kryen detyra të përcaktuara nga Rektori dhe në mungesë të tij, kryen veprimet dhe nënshkruan aktet përkatëse përveç aspekteve për të cilat sipas ligjit për arsimin e lartë dhe këtij statuti janë ekskluzivitet i Rektorit.

2. Detyrat dhe kompetencat e Zëvendës rektorit të Kolegjit Universitar “Wisdom” janë:

- a) Drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë mësimore të Kolegji Universitar “Wisdom”
- b) Është përgjegjësi kryesor për kontrollin e zbatimit të planeve dhe programeve, orarit të mësimave dhe kalendarit të praktikave, konsultimeve dhe provimeve;
- c) Ndhmon departamentet për hartimin e planeve dhe programeve mësimore për lëndët që mbulon departamenti dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
- d) Organizon dhe drejton informimin e studentëve që regjistrohen për herë të parë lidhur me mundësitë e studimeve që ofron Kolegjit Universitar “Wisdom” dhe përzgjedhjen e duhur të krediteve që nevojiten për fitimin e një diplome të caktuar si dhe mbështet dhe ndihmon studentët në hartimin e planit individual të studimeve;
- e) Organizon dhe ndjek regjistrimin dhe matrikulimin e studentëve dhe krijimin, sistemimin dhe mbajtjen sekret të të dhënave të tyre;
- f) I ofron departamentit ndihmën dhe përvojën e tij në përzgjedhjen e kandidaturave për pedagogë të brendshëm dhe të jashtëm dhe ato për punonjës kërkimorë-shkencorë të brendshëm dhe të jashtëm;
- g) I ofron departamentit informacionin e nevojshëm dhe mbështetjen për analizën e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore të departamentit dhe lidhur me masat për shkelje të disiplinës në punë nga trupi akademik ose stafi ndihmës i departamentit;
- h) I propozon Rektorit objektiva që i shërbejnë rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe përvetësimit të dijeve në Kolegjin Universitar “Wisdom”;
- i) Në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë mësimore-edukative, informon dhe ndihmon dekanin e fakultetit ose në mungesë të tij, përgjegjësin e departamentit, për probleme që lidhen me shmangiet nga zbatimi i programeve mësimore të miratuara, për mosrespektimin e orarit të mësimave, për cilësinë jo të mirë të mësimdhënies ose përvetësimin të pakënaqshëm të dijeve, për zbatimin jokorrekt të procedurave gjatë kontrollit të dijeve, për sjellje jo korrekte akademike në kampus, etj;
- j) Në bashkëpunim dhe konsultim me departamentet vendos për ndarjen ose krijimin e kurseve, grupeve dhe nëngrupeve mësimore;
- k) Mbështetur në propozimet e dekanëve, përgatit dhe paraqet për miratim në Senat strukturën mësimore dhe planin kalendarik për vitin akademik;
- l) Organizon, drejton dhe kontrollon punën për plotësimin e dokumentacionit shkollor dhe pranimin dhe lëshimin e vërtetimeve, certifikatave ose dokumenteve të tjera;
- m) Shqyrton dhe merr vendim lidhur me dokumentacionin e përgatitur nga departamentet për rastet e transferimit të studentëve;
- n) Organizon dhe drejton punën për informimin e vijueshëm të studentëve lidhur me ecurinë e rezultateve të tyre dhe rivlerësimin e karrierës së mëtejshme kur ecuria e rezultateve nuk i përmbush kërkesat e studimeve;
- o) Merr përsipër përgjegjësitë drejtuese që i delegon rektori.
- p) Ndjek dhe organizon në bashkëpunim me departamentet veprimtari të ndryshme: lektoriume, simpoziume, seminare shkencore , konferenca shkencore, etj;
- q) koordinon bashkëpunimin me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;

- r) kryhen të gjitha funksionet e tjera që i delegohen nga Rektori dhe raporton përpara atij për realizimin e tyre.

## **Neni 21**

### **Asambleja e personelit akademik**

1. Asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore, Fakultetit i Drejtësisë dhe Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë të njësisë bazë të fakulteteve.
2. Asambleja e personelit akademik ka këto funksione:
  - zgjedh me votim të fshehtë anëtarët e Senatit Akademik sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Kolegjit Universitar “Wisdom”;
  - shqyrton raportin vjetor të veprimtarisë së Kolegjit Universitar “Wisdom” para miratimit në Senat;

## **Neni 22**

### **Komisionet e përhershëm**

1. Komisionet e përhershme janë organe kolegjiale, që kryejnë funksione, që lidhen kryesisht me, garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, me mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikën e institucionit.
2. Komisionet e përhershme të KU “Wisdom” janë:
  - a) Komisioni për garantimin e standartëve të cilësisë
  - b) Komisioni për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe kurrikulën
  - c) Komisioni për marrëdhëniet me studentët, publikun dhe koordinimin.
3. Anëtarët e komisioneve të përhershme të parashikuara në pikën 2 të këtij neni vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Organizimi dhe funksionimi i komisioneve të përhershme parashikohet në rregullore të veçanta, të cilët miratohen nga Senati Akademik.

## **Neni 23**

### **Dekani**

1. Drejtuesi i njësisë kryesore është dekani i Fakultetit të Drejtësisë dhe Dekani i Fakultetit Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore. Ai është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore dhe përfaqësuesi i saj. Koordinon veprimtarinë e njësisë bazë dhe organeve kolegjiale të njësisë kryesore dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre.
2. Dekani është personel akademik i kategorisë “Profesor” dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit ose dhe jashtë tij.
3. Dekani duhet të ketë formim universitar ose kualifikime pasuniversitare në fushat që mbulon fakulteti. Dekani i Fakultetit të Drejtësisë duhet të ketë formim universitar në fushën juridike ose kualifikime pasuniversitare, në fushën e drejtësisë. Dekani i i Fakultetit Shkencave Ekonomike



dhe Shoqërore. duhet të ketë formim universitar ose kualifikime pasuniversitare në fushën e shkencave ekonomike ose shkencave shoqërore.

3. Dekani emërohet nga Rektori, me mandat 4 vjeçar, pasi merr mendimin e Senatit Akademik dhe të administratorit të shoqërisë. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë riemrimi vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike. Marrëdhëniet e tij financiare përcaktohen në kontratën e punës.

4. Mandati i Dekanit mbaron kur ai largohet, për çështje personale dhe/ose shëndetësore, në rastet e kryerjes së veprave penale me dashje ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën, të mos përmbushjes së rregullt të detyrës, për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së institucionit.

5. Dekani është autoriteti drejtues, ekzekutiv e urdhërdhënës i fakultetit, i cili, veç sa parashikohet në ligj, ka këto kompetenca:

- a) Organizon, koordinon dhe drejton procesin mësimor dhe shkencor të fakultetit;
- b) I përcjell Senatit Akademik propozimet e njësive bazë, shoqëruar me mendimet e tij;
- c) Paraqet raportin vjetor ose raportime me kërkesë të organeve të fakultetit apo inisiativë të tij për çështjet që çmon, përpara dekanatit për mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në fakultet;
- d) Paraqet në dekanat me inisiativë të tij, ose me kërkesë të organeve të fakultetit (njësive bazë) propozimet për hapjen, mbylljen, përditësimin e kurrikulave, etj.;
- e) I propozon dekanatit hapjen e degëve, qendrave, kurseve, ofrimin e shërbimeve të ndryshme për të tretë, pjesëmarrjen në projekte brenda apo jashtë vendit si dhe çdo çështje në lidhje me sa më sipër;
- f) Ushtron kontrolle për cilësinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor, të zbatimit të kontratave të punës, si dhe të çdo detyrimi tjetër të marrë përsipër nga njësitë bazë apo personeli i fakultetit;
- g) Për shkelje të disiplinës në punë që konstaton, merr masat disiplinore sipas përcaktimeve të bëra në këtë Statut.
- h) Vendos përjashtimin nga fakulteti apo nga programet e studimit të studentëve të çdo cikli në rastet dhe mënyrën e parashikuar në rregullore;
- i) Bën emërimin e zëvendës dekanit të njësive kryesore dhe të përgjegjëseve të njësive bazë;
- j) Miraton personelin akademik me kohë të pjesshme dhe personelin akademik të ftuar, sipas propozimeve të bëra nga departamentet;
- k) Propozon për emërim tek rektori kandidatët për personel akademik me kohë të plotë sipas listës së përzgjedhur nga komisioni *ad hoc* dhe procedurave të përcaktuara në nenin 45 të këtij statuti;
- l) Miraton komisionet e mbrojtjes së diplomave dhe të kualifikimeve pasuniversitare;
- m) Bën vlerësimin e performancës akademike të pedagogëve në fund të vitit akademik, dhe kur e sheh të arsyeshme, bën vlerësimin e pedagogëve edhe gjatë vitit akademik;

- n) Ngre komisionet *ad hoc* sipas parashikimeve të rregulloreve të Kolegjit Universitar “Wisdom”, komisionet e transferimit dhe të mobilitetit të studentëve, të ndërprerjes dhe rifillimit të studimeve sipas parashikimeve të Rregullores së Kolegjit Universitar “Wisdom” dhe të fakultetit;
- o) Cakton persona për kryerjen e monitorimit të provimeve që zhvillohen në fakultet;
- aa) Nënshkruan diplomat e studentëve të fakultetit përkatës, pa të drejtë për ta deleguar nënshkrimin.
- p) Propozon masat disiplinore për studentët në Këshillin e Etikës;
- q) Miraton orarin e mësimeve, komisionin e mbrojtjes së diplomave dhe urdhëron shpalljen e sesioneve të provimeve.

7. Dekani në ushtrim të kompetencave të tij shprehet me vendime, urdhëra dhe udhëzime.

#### **Neni 24**

##### **Zv.Dekani**

1. Fakulteti, në varësi të veprimtarisë, numrit të programeve të studimit, mund të caktojë një zëvendës dekan. Zëvendës dekan emërohet dhe shkarkohet nga dekan. Ai ndihmon dekanin në drejtimin e fakultetit dhe përgjigjet përpara tij dhe rektoratit për detyrat e ngarkuara.
2. Marrëdhëniet ndërmjet Kolegji Universitar “Wisdom” dhe zëvendës dekanit të fakultetit përcaktohen në kontratën e punës, e cila nënshkruhet nga rektori, pasi ka marrë pëlqimin e administratorit të shoqërisë.

#### **Neni 25**

##### **Dekanati**

1. Dekanati i Fakultetit është organ kolegjal që drejtohet nga dekan dhe përbëhet nga:
  - a) dekan;
  - b) zëvendës dekan;
  - c) administratori i fakultetit;
  - ç) drejtuesit e njësive bazë të fakultetit;
2. Dekanati harton planin strategjik të zhvillimit të Fakultetit, mbështetur në propozimet e njësive bazë, si dhe ato të administratorit të njësisë kryesore dhe koordinon veprimtarinë e njësive bazë.
3. Është organ kolegjal vendimmarrës i fakultetit, i cili veç sa parashikohet në ligj, ushtron edhe këto kompetenca.
  - a) Miraton rregulloren e fakultetit.
  - b) I propozon rektoratit për miratim strukturën dhe numrin e punonjësve në fakultet.
  - c) Miraton listën e periodikëve shkencorë ku do të pajtohet fakulteti si dhe titujt e librave që do të blihen për bibliotekën e fakultetit.
  - d) Merr në analizë aktivitetin e fakultetit dhe autoriteteve të tij, dekan, zv/dekan, administrator.
  - e) I propozon Senatit strategjinë e zhvillimit të fakultetit;
  - f) Merr në shqyrtim dhe propozon strukturën mësimore të vitit akademik;

- g) I propozon Senatit dhënien e çmimeve, titujve të nderit dhe vlerësime të tjera të Kolegji Universitar “Wisdom” për persona të veçantë.
- h) Miraton rregullat, procedurat dhe programet e kualifikimit pasuniversitar.
- i) Analizon veprimtarinë mësimore të fakultetit.
- j) Analizon veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe atë botuese të fakultetit.
- k) Miraton planet mësimore të fakultetit.
- l) Dekanati në ushtrimin e kompetencave të tij, shprehet me vendime.

## **Neni 26**

### **Këshilli i Etikës së Kolegjit Universitar “Wisdom”**

1. Këshilli i Etikës së Kolegjit Universitar “Wisdom” promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale.
2. Këshilli i Etikës është organ kolegjal vendimmarrës, i cili ngrihet pranë Kolegjit Universitar “Wisdom” si një strukturë e përhershme, që shqyrton sjellje të ndryshme të personelit akademik dhe atij ndihmës akademik të institucionit nëse përbëjnë shkelje të etikës ose jo. Këshilli shqyrton gjithashtu edhe sjellje të studentëve gjatë veprimtarisë së tyre mësimore e kërkuese në institucion, nëse ato përbëjnë shkelje të etikës së studentit.
3. Këshilli i Etikës mbledhet sa herë ka çështje për të diskutuar brenda juridiksionit të tij. Ai merr vendim me shumicë të thjeshtë (50%+1) dhe i bën propozime rektorit për këto çështje.
4. Në lidhje me çështjet e etikës dhe të integritetit akademik në Kolegjin Universitar “Wisdom”, çfarë nuk parashikohet në këtë Statut dhe në Rregulloren, do të rregullohet nga Kodi i Etikës e cila miratohet nga Senati Akademik.
5. Anëtarët e Këshillit të Etikës emërohen nga Senati Akademik prej personelit akademik, sipas propozimeve nga anëtarët e Senatit.
6. Këshilli i Etikës përbëhet nga 5 anëtarë. Këshilli i Etikës zgjedh kryetarin e tij dhe i propozon Senatit Akademik për miratim Kodin e Etikës të KU “Wisdom”.
6. Mënyra e shqyrtimit të ankesave, vendimet, sanksionet përkatëse dhe ekzekutimi i këtyre vendimeve, parashikohen në rregulloren e tij.

## **Neni 27**

### **Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë**

1. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, është një strukturë autonome, e përhershme e Kolegjit Universitar “Wisdom”. Ajo përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët përfaqësojnë njësitet kryesore të KU “Wisdom”, këshillin e studentëve, mund të bëjë pjesë dhe 1(një) anëtar në cilësinë e ekspertit të jashtëm. Anëtarët e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë emërohen nga Senati Akademik, nga radhët e personelit akademik, sipas propozimeve të bëra nga njësitet kryesore. Kryetari emërohet nga Rektori i Kolegjit Universitar “wisdom”.
2. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore - shkencore, harton relacione dhe propozon ndryshime për përmirësime

të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.

3. Njësia ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit, ajo organizon punën në bashkëpunim me njësitë bazë, për kontrollin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë sipas standardeve shtetërore të cilësisë, si dhe duke respektuar lirinë akademike në procesin e mësimdhënies/mësimnxënies.

4. Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, ajo organizon pyetësonin studentor për cilësinë e mësimdhënies dhe çështje që lidhen me procesin mësimor;

5. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë bën studime gjurmuese në bashkëpunim me Komisionin për Marrëdhëniet me Studentët për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga KU “Wisdom”.

6. Raportet e vlerësimeve, të kryera nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së Kolegjit Universitar “Wisdom”, përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

7. Organizimi dhe funksionimi i Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe i Sistemit të Vlerësimit të Brendshëm të Kolegjit Universitar përcaktohen me një rregullore të veçantë.

## **Neni 28**

### **Përgjegjësi i Departamentit**

1. Përgjegjësi i departamentit është autoriteti më i lartë për njësinë bazë mësimore dhe shkencore. Kandidati për drejtues vetëkandidohet dhe është personel akademik i kategorisë “Profesor” ose ka gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, mund të kandidojë për drejtues edhe lektori, kur ky i fundit mban gradën shkencore “Doktor”. Përgjegjësi i departamentit duhet të kenë formim universitar ose kualifikime pasuniversitare përkatëse në fushat që mbulon departamenti.

2. Përgjegjësi i departamentit bën pjesë në stafin drejtues akademik të Kolegjit Universitar “Wisdom”, është anëtar i dekanatit. Kandidatura e tij përzgjidhet nga trupi akademik i brendshëm i departamentit dhe emërohet nga dekani i fakultetit.

3. Detyrat dhe kompetencat e përgjegjësit të departamentit janë:

- a) organizon dhe drejton punën për hartimin e planeve dhe programeve mësimore për lëndët që mbulon departamenti dhe ndjek zbatimin e tyre;
- b) në emër të departamentit përcakton kriteret dhe nevojat për personel akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme;
- c) i propozon dekanit të fakultetit kandidaturat për personel akademik me kohë të plotë, sipas listës me kandidatët e përzgjedhur nga komisioni *ad hoc*, dhe propozon për miratim kandidaturat për staf akademik me kohë të pjesshme ose të atyre të ftuar;
- d) i propozon dekanit masa për shkelje të disiplinës në punë nga trupi akademik ose stafi ndihmës i departamentit;

- e) bën periodikisht analizën e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore të departamentit dhe propozon ose merr masa për përmirësimin e mëtejshëm të saj;
- f) për realizimin e detyrave dhe kompetencave të mësipërme konsultohet me zëvendësdekanin;
- g) përfaqëson departamentin dhe vepron në emër të tij në marrëdhëniet me dekanin, zëvendësrektorin, senatin, rektorin dhe bordin;
- h) në emër të departamentit, bën përpjekje të vijueshme për krijimin e lidhjeve me institucione homologe dhe promovimin e departamentit;
- i) përgjigjet për bërjen të njohur të arritjeve të departamentit nëpërmjet nxitjes së botimeve shkencore, bashkëpunimit në projekte si dhe përfshirjes nëpërmjet përditësimit të rubrikave përkatëse në “web site” të Kolegjit Universitar “Wisdom”;
- j) ndjek dhe përgjigjet për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore-shkencore të departamentit;
- k) është anëtar i dekanatit;
- l) organizon dhe drejton punën për hartimin e teksteve mësimore për lëndët që mbulon departamenti;
- m) bën shpërndarjen e ngarkesës mësimore dhe asaj kërkimore-shkencore të departamentit;
- n) bashkëpunon ngushte me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për problemet që kanë të bëjnë me cilësinë e mësimdhënies dhe përvetësimin e dijeve nga studentët;
- o) miraton komisionet e provimeve dhe tezat e provimit;
- p) propozon përbërjen e komisioneve të mbrojtjes së diplomave dhe të komisioneve të kualifikimit universitar e pasuniversitar;
- q) mbikëqyr veprimtaritë shkencore në departament, në përputhje me planifikimin vjetor, mban dokumentacionin e aktivitetit shkencor e akademik të personelit akademik të departamentit, pas raportimeve në analizën vjetore të tij;
- r) mbikëqyr respektimin e programeve të mësimdhënies në kohën e në mënyrën e caktuar, kërkimeve shkencore dhe veprimtarive të tjera;
- s) mbikëqyr dhe nënshkruan realizimin e ngarkesës mësimore të personelit akademik;
- t) i rekomandon dekanatit kriteret e posaçme të pranimit të personelit akademik e ndihmës akademik për departamentin, pas diskutimit paraprak në departament;
- u) i paraqet dekanatit kriteret dhe listën me personel akademik me kontratë të përkohshme dhe të ftuar, pas diskutimit paraprak në departament;
- v) propozon në dekanat, mbylljen apo ndryshimin e grupeve mësimore e kërkimore, strukturën e tyre e ndryshime të saj në përputhje me Statutin.
- w) organizon analiza periodike ose për raste e aspekte të veçanta në departament dhe analizën vjetore të punës mësimore shkencore të tij.
- x) evidenton, verifikon dhe kur është rasti i propozon dekanatit masat për shkeljet e disiplinës në punë nga punonjësit e departamentit sipas përcaktimeve të rregullores së fakultetit
- y) mbikëqyr respektimin e disiplinës në punë, merr masat përkatëse për rivendosjen e rregullit në rast shkeljesh dhe të metash. Në rastet e rënda ose kur e çmon njofton dekanin me rekomandimet përkatëse organizative e disiplinore.

## **Neni 29**

### **Përgjegjësi i grupit mësimor e kërkimor**

1. Departamentet, në varësi të programeve të studimit dhe veprimtarisë së tyre, mund të kenë edhe përgjegjës të grupit mësimor e kërkimor.
2. Veç detyrave të tjera të përcaktuara nga aktet normative në fuqi, përgjegjësi i grupit mësimor e kërkimor, ka edhe këto detyra për ushtrimin e funksioneve të tij:
  - a) Organizon hartimin e kurrikulave të disiplinave që mbulon grupi dhe i paraqet në departament për diskutim.
  - b) Mbikëqyr respektimin e programeve të mësimdhënies në kohën e në mënyrën e caktuar, kërkimeve shkencore dhe veprimtarive të tjera.
  - c) Ndjek aktivitetin shkencor të anëtarëve të grupit dhe për problemet që lindin informon autoritetet drejtuese.
  - d) Raporton tek përgjegjësi i departamentit për realizimin e programit mësimor në përfundim të çdo semestri duke pasqyruar dhe mendimet e grupit mësimor kërkimor.
  - e) Organizon analizën vjetore të punës dhe depoziton në departament dokumentacionin e aktivitetit shkencor të secilit anëtar
  - f) Mbikëqyr dhe nënshkruan realizimin e ngarkesës mësimore të grupit.
  - g) Evidenton, verifikon dhe kur është rasti i propozon përgjegjësit të departamentit për shkeljet e disiplinës në punë nga punonjësit e grupit.
  - h) Mbikëqyr respektimin e disiplinës në punë, merr masat përkatëse për rivendosjen e rregullit në rast shkeljesh e të metash. Në rastet e rënda ose kur e çmon njofton përgjegjësin e departamentit dhe dekanin/drejtorin me rekomandimet përkatëse organizative e disiplinore.

## **Neni 30**

### **Personeli ndihmës akademik**

1. Personeli ndihmës akademik i KU “Wisdom” përbëhet nga:
  - a) Biblioteka (personel ndihmës akademik me karakter mësimor), dhe
  - b) Sekretaria mësimore (personel ndihmës akademik me karakter administrativ).
1. Kriteret e punësimit dhe procedurat e emërimit përcaktohen në nenet në vazhdim të këtij statuti.
2. Organizimi dhe funksionimi i bibliotekës dhe sekretarisë mësimore përcaktohen në rregulloren e KU “Wisdom” dhe në rregullore të veçanta

## **KREU III**

### **ORGANIZIMI ADMINISTRATIV**

## **Neni 31**

### **Struktura administrative**

1. Struktura administrative e Kolegjit Universitar “Wisdom” përbëhet nga:
  1. Struktura administrative e Kolegjit Universitar “Wisdom” përbëhet nga:
    - Bordi i Administrimit,
    - Administratori i Kolegjit Universitar,
    - Administratorët e fakulteteve,
    - Zyra e financës
    - Zyra e burimeve njerëzore
    - Zyra e karrierës dhe jetës studentore
    - Shërbimi i IT
    - Zyra e shërbimeve
  2. Struktura administrative me karakter ndihmës akademik përbëhet nga:
    - Sekretaria mësimore
    - Biblioteka
    - Arkiva dhe protokolli

### **Neni 32**

#### **Bordi i Administrimit, përbërja dhe organizimi i tij**

1. Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të Kolegjit Universitar “Wisdom”, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.
2. Për të realizuar misionin e tij, Bordi:
  - a) i rekomandon administratorit të shoqërisë ndryshimet e nevojshme në infrastrukturë (mjedise mësimore dhe ndihmëse, teknologji të reja të mësimdhënies dhe edukimit, literaturë, etj.), në cilësi akademike (kualifikime të trupit akademik, trajtime financiare, krijim i lidhjeve me institucione homologe, etj) dhe në veprimtaritë e Kolegjit Universitar “Wisdom” (konferenca, takime, veprimtari publike, marketing, etj.),
  - b) jep rekomandime dhe orienton shfrytëzimin sa më të mirë të buxhetit të dërguar dhe të mbrojtur në Bord nga Rektori, para miratimit përfundimtar të tij nga Administratori apo Asambleja e Ortakeve.
  - c) udhëzon dhe orienton për rritjen e efektivitetit të veprimtarive publike dhe të procesit të marketingut që zhvillohet në kuadër të vetë Kolegjit Universitar “Wisdom”.
  - d) brenda buxhetit vjetor të miratuar në mënyrë përfundimtare, i bën propozime administratorit për ndryshime dhe rregullime të domosdoshme të nivelit të pagesave të pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm,
  - e) shqyrton dhe miraton politikat e përgjithshme operuese të Kolegjit Universitar “Wisdom”, politikat konkrete të mësimdhënies dhe rekrutimit të trupit akademik, programet jashtë mësimore të kërkimit, botimet mësimore-shkencore, trajnimet e ndryshme, kriteret e dhënies së granteve apo bursave të veçanta.
3. Bordi i Administrimit i Kolegjit Universitar “Wisdom” përbëhet prej 5 (pesë) anëtarë me të drejtë vote, ku bëjnë pjesë figura publike me përvojë, reputacion e kontribut në çështje

administrative, ekonomike, social - kulturore, në fushën e arsimit të lartë dhe të shkencës. Anëtarët e Bordit të Administrimit miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.

4. Pesë anëtarë janë përfaqësues të shoqërisë “Wisdom” shpk, janë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, ekonomike, juridike ose të pushtetit vendor, mund të jenë ortake të shoqërisë dhe emërohen nga administratori i shoqërisë “Wisdom”.

4. Rektori, drejtuesit e njësive kryesore, drejtuesit e njësive bazë dhe administratorët e institucionit dhe të njësive kryesore dhe bazë nuk mund të jenë anëtarë të Bordit të Administrimit, por mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e tij.

5. Bordi, me propozim të administratorit të shoqërisë, zgjedh kryetarin e tij midis anëtarëve me të drejtë vote, me 3/5 e anëtarëve të tij. Kryetari drejton veprimtarinë e Bordit dhe mbledhjet e tij. Në mungesë të tij, këtë detyrë e kryen një anëtar i Bordit, të cilit i delegohet detyra, me gojë a shkrim, nga vetë kryetari. Mandati i kryetarit është dyvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

6. Bordi miraton edhe një sekretar. Sekretari nuk është anëtar i Bordit, por pjesë e stafit akademik, ndihmës akademik ose ndihmës administrativ i Kolegjit Universitar “Wisdom”.

7. Bordi, gjatë veprimtarisë së tij, pas një këshillimi paraprak me Administratorin e Shoqërisë dhe Rektoren, mund të krijojë struktura ndihmëse e komisione për çështje të veçanta dhe për kohë të caktuar.

8. Rektori dhe administratori i Kolegjit Universitar “Wisdom”, detyra e të cilëve nuk pajtohet me anëtarësinë në Bord, mund të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e Bordit, kur e vlerësojnë ata vetë, si dhe kur thirren nga ky Bord.

### **Neni 33**

#### **Funksionet e Bordit**

1. Bordi është organ kolegjal vendimmarrës, që mbikëqyr e kontrollon veprimtarinë e institucionit të arsimit të lartë, që lidhen me menaxhimin administrativ, financiar, ekonomik dhe të pronave të tij.

2. Funksionet kryesore të bordit janë:

- a) garanton qëndrueshmërinë financiare të Kolegjit Universitar “Wisdom” dhe përmbushjen e misionit të saj;
- b) me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
- c) me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
- d) me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;
- e) vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
- f) miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;



- g) jep mendim për projekt rregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
- h) përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;
- i) është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;
- j) emëron dhe shkarkon administratorin e Kolegjit Universitar “Wisdom” me propozim të administratorit të shoqërisë;
- k) miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t’i përcillet Senatit Akademik, me jo më pak se tre të pestën e votave të anëtarëve;
- l) miraton paraprakisht kandidatin për rektor të Kolegjit Universitar, para emërimit të tij nga administrator i shoqërisë;
- m) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati.
- n) miraton kriteret për ndarjen e burimeve financiare;
- o) miraton, me kërkesën e senatit akademik, projektbuxhetin e institucionit me dy të tretat e votave;
- p) vlerëson efikasitetin e përdorimit të burimeve financiare sipas buxhetit të miratuar;
- q) miraton numrin e personelit akademik dhe ndihmës akademik të Kolegjit Universitar “Wisdom”, sipas propozimeve të bëra nga strukturat përkatëse;
- r) miraton raportin vjetor financiar të paraqitur nga administratori i Kolegjit Universitar “Wisdom”;
- s) vlerëson planin e zhvillimit të institucionit e programin vjetor të veprimtarive të tij;
- t) miraton rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin;
- u) përcakton kriteret dhe procedurat e dhënies së bursave për studentët;
- v) miraton rregulloren e funksionimit të tij, të zyrës së karrierës dhe akteve të tjera të karakterit administrativ dhe financiar.

### **Neni 34**

#### **Mbledhja e Bordit**

1. Mbledhja e Bordit quhet e vlefshme kur plotësohet kuorumi. Kuorumi është prania në mbledhje e shumicës absolute të anëtarëve të Bordit. Ndërsa për miratimin e buxhetit kërkohet një kuorum dhe shumicë prej 2/3 të anëtarëve të tij.
2. Mbledhja vjetore e Bordit mbahet në shtator të çdo viti. Si rregull, Bordi thirret në mbledhje një herë në tre muaj, me përjashtim të rasteve kur në mbledhjen e radhës vendoset ndryshe ose kur kryetari i Bordit, administratori i shoqërisë ose 1/3 e anëtarëve të tij kërkojnë mbledhje jashtë radhe. Në fillim të mbledhjes së Bordit bëhet miratimi i materialeve të mbledhjes së mëparshme, të zbardhura nga sekretari.
3. Anëtarët e Bordit, përveç pjesëmarrjes me praninë e tyre fizike, mund të marrin pjesë në veprimtaritë e Bordit edhe me mënyra të tjera të miratuara paraprakisht nga Bordi për çështje

konkrete.

4. Bordi shqyrton dhe miraton me shumicë të thjeshtë votash:

- kërkesat arsimore dhe të kualifikimit për rekrutimin e trupit akademik,
- përshkrimin e vendeve të punës dhe kriteret e konkurrimit për stafin drejtues,
- procedurat e emërimeve, me qëllim shmangien e diskriminimit dhe konfliktin e interesave,
- miraton modelin e kontratave me kohë të pacaktuar (pa afat).

### **Neni 35**

#### **Marredhëniet e Shoqërisë “Wisdom”shpk me KU “Wisdom”**

1. Kolegji Universitar “Wisdom” është krijuar me kërkesë të Shoqërisë “Wisdom”shpk, Tiranë, i cila është përgjegjëse për të gjithë veprimtarinë, administrimin dhe financimin e saj.
2. Marrëdhëniet e Shoqërisë “Wisdom”shpk me KU“Wisdom” mbahen nëpërmjet Bordit të Administrimit të përfaqësuar nga Administratori i Shoqërisë, në përputhje me nenin 48, të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet e nënligjore të dala në zbatim të tij.
3. Administratori i shoqërisë nënshkruan kontratat e punës me personelin administrativ të emëruar sipas procedurave të përcaktuara në këtë statut.

### **Neni 36**

#### **Financimi, kontrolli dhe auditimi i Kolegjit Universitar “Wisdom”**

1. KU“Wisdom” është institucion jopublik me vetëfinancim. Të ardhurat e tij krijohen nga tarifat e studimit të studentëve dhe nga të ardhura të tjera të ligjshme.
2. KU“Wisdom” ka të drejtë të pranojë ndihma financiare që lidhen me objektin e veprimtarisë së tij në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Ai paguan rregullisht taksat, tatimet dhe detyrimet e tjera ndaj shtetit dhe ndaj të tretëve. Veprimtaria ekonomike dhe financiare e saj pasqyrohet në bilancet vjetore të tij. Ai mban kontabilitet të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.
3. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm i Kolegjit Universitar “Wisdom” realizohet nga njësia e auditimit të brendshëm të institucionit. Njësia krijohet me vendim të asamblesë së ortakëve të shoqërisë dhe përbëhet nga ekonomistë dhe ekspertë kontabël.
4. Kontrolli dhe auditimi i jashtëm në institucionet e arsimit të lartë kryhen nga auditues të brendshëm ose të jashtëm, të përzgjedhur nga ministria përgjegjëse për arsimin nga lista e përditësuar çdo vit nga Ministria e Financave.

### **Neni 37**

#### **Administratori i Kolegjit Universitar “Wisdom”**

1. Administratori i Kolegjit Universitar “Wisdom” është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i

institucionit të arsimit të lartë për çështjet financiare dhe administrative, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë.

2. Administratori emërohet dhe shkarkohet nga Bordit të Administrimit, pasi ka marrë miratimin administratori i shoqërisë.

3. Administratori duhet të ketë arsim të lartë, së paku në nivelin “Master i shkencave” në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune së paku shtatë vjet në këto fusha.

4. Administratori nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ.

5. Administratori i raporton për veprimtarinë e tij Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik, të paktën një herë në vit, për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative dhe financiare.

### **Neni 38**

#### **Funksionet e administratorit të Kolegjit Universitar “Wisdom”**

1. Administratori kryen këto funksione:

- a) drejton veprimtarinë ekonomike, financiare e administrative.
- b) harton projekt buxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në atë të veprimtarisë vjetore të Kolegji Universitar “Wisdom” dhe ia paraqet Bordit për shqyrtim dhe miratim.
- c) ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të Kolegjit Universitar dhe në strukturat e varësisë së tij;
- d) zbaton të gjitha vendimet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit Akademik me karakter financiar dhe administrativ;
- e) i paraqet Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik raportin mbi veprimtarinë financiare të institucionit të arsimit të lartë, në përfundim të vitit akademik;
- f) bashkëpunon me strukturat dhe autoritetet e tjera të institucionit të arsimit të lartë për çështje të administrimit të përditshëm;
- g) emëron dhe shkarkon administratorët e njësive kryesore dhe njësive bazë pas miratimit të Bordit të Administrimit;
- h) plotëson kërkesat e rektorit, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare.
- i) përgatit dhe drejton planin e marketingut të Kolegjit Universitar, në bashkëpunim me departamentet, fakultetin dhe rektoratin;
- j) organizon dhe mban përgjegjësi për komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm, internetit, etj;
- k) organizon periodikisht kontroll-revizionin e brendshëm dhe bën analiza me karakter ekonomiko-financiar të cilat ja paraqet administratorit të shoqërisë dhe Bordit të administrimit për shqyrtim dhe miratim;
- l) organizon konkurset për përzgjedhjen e personelit ndihmës akademik me karakter mësimor dhe administrativ;

- m) ndjek dhe përgjigjet për arkëtimin e tarifave të studimit dhe të ardhurave të tjera nga veprimtaria e Kolegjit Universitar “Wisdom”;
- n) përgjigjet për shlyerjen e detyrimeve të Kolegjit Universitar ndaj organeve shtetërore, për pagimin e taksave, tatimeve si dhe për detyrimet ndaj të tretëve;
- o) mbikëqyr mbajtjen në eficiencë të plotë të aparaturave dhe pajisjeve didaktike dhe atyre të kërkimit shkencor;
- p) përgjigjet për plotësimin në kohë të kërkesave të fakulteteve, të departamenteve, dhe strukturave të tjera të KU “Wisdom”, për materiale, kancelari dhe shërbime;
- q) përgjigjet për mbajtjen në eficiencë të plotë të sistemit ngrohës, sistemit elektrik dhe atij hidraulik në të gjitha mjediset e Kolegjit Universitar;
- r) përgjigjet për organizimin dhe kryerjen me cilësi të shërbimeve të tjera në kampus (shërbimi i rojës, shërbimi i bibliotekës, shërbimi sanitar, etj.);
- s) nënshkruan në emër të Kolegjit Universitar “Wisdom” kontratën e regjistrimit me studentët ose kujdestarët e tyre, për të cilët është miratuar regjistrimi;
- t) administratori për të mundësuar ushtrimin e kompetencave të tij mund ti propozojë Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik krijimin, shkrirjen ose ndryshimin e hallkave, të strukturave ose edhe të shërbimeve.

### **Neni 39**

#### **Administratori i njësive kryesore**

1. Administratori i Fakultetit është përgjegjës për mirëfunksionimin financiar dhe administrativ të tyre.
2. Administratori i njësisë kryesore duhet të ketë formim universitar, së paku në nivelin “Master i shkencave” në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune, së paku pesë vjet në këto fusha. Ai emërohet nga administrator i KU “Wisdom”, pasi ka marrë miratimin e asamblesë së ortakëve. Kontrata e punës nënshkruhet nga administratori i shoqërisë.
4. Administratori i njësisë kryesore nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ.
5. Administratori i njësisë kryesore i raporton për veprimtarinë e tij administratorit të KU “Wisdom”, si dhe informon drejtuesin e njësisë kryesore, për çështje që lidhen me procesin mësimor;

### **Neni 40**

#### **Funksionet e administratorit të fakultetit**

1. Funksionet e administratorit të njësive kryesore janë:
  - a) realizon administrimin e përditshëm financiar të njësisë kryesore;
  - b) mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë financiare të njësisë kryesore;
  - c) plotëson kërkesat e drejtuesit të njësisë kryesore, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;
  - d) bashkëpunon me autoritetet dhe organet drejtuese të njësisë kryesore për çështjet themelore të administrimit të saj.

**KREU IV**  
**PERSONELI I KOLEGJI UNIVERSITAR “WISDOM”**

**Neni 41**

**Personeli i Kolegjit Universitar “Wisdom”**

Personeli i Kolegjit Universitar “Wisdom” përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës akademik dhe personeli administrativ. Punësimi i tyre mund të jetë me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, sipas detyrimeve të përcaktuara në nenin 57, pikat 1,2,3 të ligjit për arsimin e lartë.

**Neni 42**

**Kategoritë e personelit akademik**

1. Personeli akademik në institucionet e arsimit të lartë kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të institucionit të arsimit të lartë, këshillim për studentët si dhe veprimtari të tjera.
2. Personeli akademik mund të jetë me orientim mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor. Personeli akademik në institucionet e arsimit të lartë, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në tre kategori:
  - a) profesorë;
  - b) lektorë;
  - c) asistent-lektorë.
3. Në kategorinë “Profesorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore - shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë “Profesor” ose “Profesor i asociuar”.
4. Në kategorinë “Lektorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, që zhvillojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në këtë kategori përfshihen anëtarët e personelit akademik që mbajnë gradën shkencore “Doktor”, kanë së paku tre vite eksperiencë në mësimdhënie para ose pas fitimit të kësaj grade dhe përmbushin kriteret e përcaktuara në statutin e institucionit të arsimit të lartë. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.
5. Në kategorinë “Asistent-lektorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore-kërkimore. Asistent-lektorët duhet të kenë së paku diplomën “Master i shkencave” dhe të përmbushin kriteret e përcaktuara në statutin e institucionit të arsimit të lartë. Asistent-lektori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të caktuar.
6. Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Në kolegjet profesionale të larta, personeli akademik duhet të ketë fituar së paku diplomën “Master profesional”.

### **Neni 43**

#### **Norma mësimore**

1. Mësimdhënia është detyrim për të gjithë personelin akademik me kohë të plotë. Personeli akademik me kohë të plotë është i detyruar të plotësojë normën mësimore-shkencore sipas përcaktimeve ligjore, në kontratën e punës dhe në përputhje me vendimin e senatit dhe udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Përveç kohës së mësimdhënies, pjesën tjetër të kohës punonjësi është i detyruar t'ia kushtojë përgatitjes, kualifikimit, kërkimit shkencor, hulumtimit dhe publikimit të punës dhe arritjeve të tij.
2. Niveli i pagës së pedagogëve dhe punonjësve kërkimorë-shkencorë të brendshëm lidhet drejtpërdrejtë me kualifikimin shkencor dhe rezultatet në punë, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

### **Neni 44**

#### **Statusi i personelit akademik**

1. Personeli akademik gëzon status dhe trajtim të veçantë. Statusi i veçantë konsiston në liritë akademike, të drejtat ekonomiko-financiare, detyrimet dhe përgjegjësitë, si dhe garancitë ligjore në zbatim të tyre.
  2. Personeli akademik gëzon liri akademike në 4 (katër) drejtime të veprimitarisë së tij, në:
    - a) Mësimdhënie;
    - b) Punë kërkimore-shkencore;
    - c) Kontribut institucional;
    - d) Kontribut profesional.
- Liria akademike nuk përjashton të drejtën e vlerësimit të performancës së personelit akademik dhe të drejtën e studentëve dhe palëve të treta për të mos qenë dakord me punën e tij.
3. Personeli akademik nuk mund të penalizohet për shkak të qëndrimeve të tij kundër politikave institucionale. Në të gjitha rastet personeli akademik vepron brenda etikës, në respekt të institucionit dhe kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.
  4. Personeli akademik e humbet statusin kur kontrata përfundon/zgjidhet.
  5. Çdo anëtar i personelit akademik nuk mund të diskriminohet nga institucioni për shkak të rezultateve të punës së tij kërkimore shkencore, të kryera në përputhje misionin e institucionit të arsimit të lartë.
  6. Në rast se një anëtar i personelit akademik konstaton se i është cenuar liria akademike ose është objekt diskriminimi, i drejtohet Këshillit të Etikës të Kolegjit Universitar "Wisdom". Procedura e trajtimit të ankesave kryhet duke respektuar të gjithë elementët e një procesi të rregullt ligjor, në përputhje me rregulloren e Këshillit të Etikës. Personeli akademik mund t'i drejtohet dhe drejtpërdrejtë ministrit përgjegjës për arsimin, në rast se i cenohet liria akademike dhe statusi i tij, vetëm pasi ka realizuar procedurën e trajtimit të ankesës sipas pikës 6 të këtij neni.

### **Neni 45**

#### **Punësimi i personelit akademik**

1. Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme përcaktohen nga njësitë bazë, bazuar në nevojat e tyre, dhe miratohen nga dekani. Pranimi bëhet me konkurs i cili drejtohet nga një komision *ad hoc*, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë bazë përkatëse.
2. Për përzgjedhjen e pedagogëve, me propozim të dekanit të fakultetit dhe miratim të rektorit të Kolegjit Universitar, ngrihet dhe funksionon një komision *ad hoc*, “Komisioni i vlerësimit dhe përzgjedhjes të personelit akademik”, i përbërë nga pedagogë dhe punonjës kërkimorë-shkencorë të brendshëm dhe me përvojë të departamenteve.
3. Dekani i fakultetit është kryetar i komisionit *ad hoc*, për shkak të detyrës. Ai bën propozimin për emërim dhe për punësimin si pjesë e stafit akademik të kandidaturës së përzgjedhur, e cila është kusht për lidhjen e kontratës së punës mes pedagogut dhe Kolegjit Universitar “Wisdom”;
4. Kandidati i përzgjedhur merret fillimisht në punë me kontratë pune 3 (tre) mujore deri 1 (një) vjeçare. Punonjësit të kategorisë “Lektor” mund të emërohet në punë pas përfundimit të kontratës dhe plotësimit të kushteve të saj. Emërimi në këto raste bëhet nga rektori, sipas listës të komisionit *ad hoc*, dhe me propozim të dekanit, sipas nevojave të departamenteve.
5. Kontratat e punësimit, pas emërimit të punonjësit nga organi i emërtesës, ciklohet nga administratori i shoqërisë
6. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në një institucion të arsimit të lartë nuk mund të punësohet si personel akademik me kohë të plotë në një institucion tjetër të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit. Ai mund të angazhohet me kohë të pjesshme vetëm në një institucion tjetër të arsimit të lartë, me miratimin e drejtuesit të njësisë kryesore dhe të rektorit, si dhe në marrëveshje mes institucioneve. Pjesëmarrja e personelit akademik në projekte, konsulenca, botime dhe shërbime të ndryshme që realizohen në KU “Wisdom”, në bashkëpunim ose në interes të tij, nuk konsiderohet si dy punësim brenda institucionit.
7. Personeli akademik me kohë të pjesshme, sipas nevojave të departamenteve, propozohen prej tyre, pas shqyrtimit në mbledhje të departamentit, dhe miratohen nga dekani i fakultetit. Kandidatët për këto vende pune konkurrojnë me dosje pranë njësisë bazë. Departamenti bën renditjen e kandidatëve sipas plotësimit të kërkesave të publikuara dhe që i përgjigjen përshkrimit të vendit të punës dhe i paraqet për emërim autoritetit drejtues të njësisë kryesore, kandidatin e renditur i pari në klasifikim.

## **Neni 46**

### **Kontrata e punës**

1. Anëtarët e personelit akademik të kategorisë “Profesor” dhe “Lektorë” punësohen në KU “Wisdom” me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.
2. Anëtarët e personelit akademik të kategorisë “Asistentë-lektorë” punësohen në KU “Wisdom” me kontratë me kohëzgjatje të caktuar.
3. Të dyja këto kategori mund të punësohen me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme. Njoftimi i përfundimit të kontratës së punës për personelin akademik bëhet sipas përcaktimeve të Kodit të Punës.

4. Personeli akademik nuk mund të largohet/ndryshohet gjatë kryerjes së punës së tij kërkimore – shkencore në një projekt të ndjekur prej tij që nga fillimi, pa miratimin e tij, përveç rasteve të shkeljeve të rënda të vërtetuara.

5. Kontratat e punës me personelin akademik, të emëruar sipas procedurave të përcaktuara në nenin 45 të këtij statuti, nënshkruhen nga rektori i KU “Wisdom”.

#### **Neni 47**

##### **Koha e punës dhe e lejes**

1. Personeli akademik me kohë të plotë në KU “Wisdom” realizon ngarkesën mësimore sipas kuadrit ligjor në fuqi.

2. Personeli akademik, brenda kohës efektive të punës, mund të kryejë detyra akademike, shkencore ose në mbështetje institucionale ndaj të tretëve, pasi ka marrë miratimin e titullarit të Kolegji Universitar.

3. Personeli akademik për aktivitete që lidhen me 4 drejtimet e punës së tij sipas pikës 2 të nenit 44 të këtij statuti, ka të drejtën e përfitimit të një leje deri në dy javë, me miratim nga përgjegjësi i departamenti, që informon në çdo rast drejtuesin e njësisë kryesore. Për kohëzgjatje deri në 4 javë, leja merret nga drejtuesi i njësisë kryesore, i cili njofton për çdo rast rektorin. Kërkesa për leje me afat më të gjatë miratohet nga rektori. Në të gjitha rastet, kërkesat për leje duhet të jenë të dokumentuara dhe të justifikuara, në bazë të një agjende zyrtare pranë zyrës së burimeve njerëzore.

5. Personeli akademik me miratimin e rektorit, pasi ka marrë dhe pëlqimin paraprak të përgjegjësit të departamentit dhe dekanit të fakultetit mund të kryejë dhe detyra të larta në administratën publike, vendase apo të huaja, për një periudhë jo më shumë se 5 vite pa ndërprerje. Gjatë kësaj periudhe atij i ruhet vendi i punës.

6. Anëtarët e personelit akademik të cilët kandidojnë dhe zgjidhen në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë apo për organet e qeverisjes vendore, njoftojnë me shkrim përgjegjësin e departamentit, dekanin dhe rektorin e institucionit të arsimit të lartë. Gjatë ushtrimit të aktivitetit politik, veprimtaria akademike pezullohet dhe nuk përfitohet pagë.

#### **Neni 48**

##### **Të drejtat dhe detyrat e personelit akademik:**

1. Personeli akademik i Kolegjit Universitar “Wisdom” ka edhe këto të drejta të tjera:

- a) të përparojë në karrierën akademike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- b) të trajnohet, të kualifikohet në institucionet akademike e kërkimore shkencore, brenda dhe jashtë vendit, sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me profesionin;
- c) të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet e Kolegjit Universitar, duke kryer aktivitete zgjedhore në përputhje me rregulloret e saj.

2. Personeli akademik i Kolegjit Universitar “Wisdom” ka këto detyra dhe përgjegjësi kryesore:



- a) të njohë, të respektojë, të zbatojë dhe të veprojë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
  - b) të respektojë orarin e punës dhe ta shfrytëzojë vetëm për kryerjen e detyrave. Koha (orari) e punës dhe e mësimdhënies, përcaktohen nga kontrata e punës.
  - c) të rrisë aftësitë profesionale akademike dhe të marrë pjesë në veprimtari trajnuese për këtë qëllim;
  - d) të mos kërkojë ose pranojë asnjë përfitim material, për kryerjen e detyrave akademike me përjashtim të pagës dhe të përfitimeve të tjera, të përcaktuara me ligj e akte të tjera nënligjore;
  - e) të mbajë përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e veprimeve të veta, gjatë kryerjes së detyrës si personel akademik në KU “Wisdom”;
  - f) të zbatojë etikën institucionale në respektim të imazhit të institucionit të arsimit të lartë dhe të figurës së titullarit të tij.
  - g) të zbatojë kodin e etikës në veshje e sjellje gjatë kohës së ushtrimit të aktivitetit akademik;
3. Bordi i Administrimit me propozim të Rektorit ose Administratorit të Kolegji Universitar mund të akordojë trajtim të veçantë, si dhe përfitime të tjera për personelit akademik.

#### **Neni 49**

##### **Personeli akademik i ftuar**

1. Njësitë bazë të Kolegjit Universitar “Wisdom” kanë të drejtë të kërkojnë të punësojnë me kontratë për periudha të shkurtra kohe studiuës, personalitete vendas ose të huaj.
2. Për përzgjedhjen e personelit akademik të ftuar ndërthuren kualifikimet e tyre me nevojën e njësisë bazë për veprimtari mësimdhënie ose kërkimore-shkencore.
3. Personeli i ftuar propozohet nga departamentet, pas shqyrtimit në mbledhje të departamentit, dhe miratohet nga dekani i fakultetit, pasi ka marrë mendimet e rektorit dhe të administratorit të shoqërisë.

#### **Neni 50**

##### **Viti akademik sabbatik**

Personeli akademik i kategorisë “Lektor” dhe “Profesor”, me miratim të njësisë bazë ku zhvillon veprimtarinë akademike, ka të drejtë të shkëputet nga angazhimet e institucionit, një herë në shtatë vjet, për periudha kohe deri në një vit, për të punuar për përparimin e tij akademik. Në këto raste i ruhet vendi i punës si dhe i jepet një trajtim financiar që përcaktohet në kontratën e punës.

#### **Neni 51**

##### **Kohëzgjatja e punësimit të personelit akademik**

1. Personeli akademik, që mban titullin “Profesor”, shërben në detyrë deri në moshën 68 vjeç, me përjashtim të rastit kur, me kërkesën e tij, largohet nga detyra. Mbështetur mbi nevojat e Kolegjit Universitar dhe me pëlqimin e tij, ai mund të shërbejë në detyrë edhe pas moshës së lartpërmendur, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit.

2. Personeli akademik, që mban titullin “Profesor i asociuar”, shërben në detyrë deri në moshën 65 vjeç. Mbështetur mbi nevojat e KU “Wisdom” dhe me pëlqimin e tij, ai mund të shërbejë në detyrë edhe pas moshës së lartpërmendur, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit. Në raste të veçanta edhe për personalin akademik të kategorisë “Lektor” kur shikohet e nevojshme nga njësitë bazë, duke ndërthurur nevojat dhe aftësitë e tij, mund të shërbejë në detyrë edhe pas moshës 65 vjeç, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit.

## **Neni 52**

### **Trajtimi i veçantë i personelit akademik**

1. Personeli akademik ka të drejtën e përfitimit të shpërblimit shtesë që ka lidhje me performancën e tij dhe strategjinë e zhvillimit të KU “Wisdom”, sipas përcaktimeve të akteve të brendshme të KU “Wisdom”.
2. Personeli akademik mund të përfitojë kompensim e rimbursim financiar kur punon për aktivitetet e tij në 4 drejtimet e përcaktuara në pikën 2, neni 45, sipas procedurave të përcaktuara nga Bordi i Administrimit, në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Kolegji Universitar.
3. Personeli akademik ka të drejtë që, në raste të veçanta, të kërkojë leje pa të drejtë page, për arsye shëndetësore, personale, për fëmijët, bashkëshortin/bashkëshorten ose prindërit. Kohëzgjatja maksimale e të gjitha lejeve të papaguara brenda një viti kalendarik nuk mund të jetë më e gjatë se 30 ditë.
4. Personeli akademik në periudhën e arsimimit, të trajnimit ose të kualifikimit në kurse, shkolla ose universitete, brenda dhe jashtë vendit, mund të përfitojë pagë dhe kompensime si më poshtë:
  - a) për periudha arsimimi, trajnimi ose kualifikimi në kurse, akademi ose universitete brenda vendit, pagën e plotë mujore, së bashku me të gjitha kompensimet;
  - b) për periudha arsimimi, trajnimi ose kualifikimi në kurse ose universitete jashtë vendit, pagën bazë për grade shkencore ose titullin që mban .
5. Në rastet kur personeli akademik vdes, pëson sëmundje të rëndë e të gjatë ose dëmtime të mëdha të pronës, si rezultat i një fatkeqësie natyrore, familjes ose atij mund t’i jepet ndihmë financiare e menjëhershme në masën deri në tre paga mujore.
6. Këto përfitime financiare miratohen nga bordi i administrimit, me propozim të rektorit, administratorit të Kolegji Universitar ose administratorit të shoqërisë.

## **Neni 53**

### **Personeli ndihmës akademik**

1. Personeli ndihmës akademik ndahet në personel ndihmës akademik me karakter mësimor dhe ndihmës akademik me karakter administrativ.
2. Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor. Ai është pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Në këtë kategori futen IT, laborantët, teknikët, si dhe personeli i Institutit për Kërkim dhe Zhvillim “Wisdom”, personeli i Klinikës së Ligjit “Wisdom”, Klinika Psikologjike Urtësia etj..

3. Personeli ndihmës akademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të Kolegjit Universitar “Wisdom” në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel institucional. Në këtë kategori futen daktilografistë, redaktor gjuhësor, etj..
4. Kriteret e punësimit të personelit ndihmës-akademik, me kohë të plotë, propozohen nga njësia së cilës ky personel i shërben, bazuar në nevojat e kësaj të fundit. Konkursi drejtohet nga një komision *ad hoc*, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë përkatëse, i kryesuar nga administratori i njësisë kryesore.
5. Personeli ndihmës akademik miratohet nga administratori i Kolegjit Universitar, nga lista e përzgjedhur e kandidatëve nga komisioni dhe propozimeve të bëra nga administratori i njësisë kryesore;
6. Kontrata e punës me personelin ndihmës akademik me karakter mësimor nënshkruhet nga rektori

#### **Neni 54**

##### **Personeli administrativ**

1. Kategoritë e personelit administrativ dhe nivelet e pagave miratohen nga Bordi i Administrimit të Kolegjit Universitar “Wisdom”, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Kriteret e punësimit të personelit administrativ, me kohë të plotë, propozohen nga njësia së cilës ky personel i shërben, bazuar në nevojat e kësaj të fundit. Konkursi drejtohet nga një komision *ad hoc*, i kryesuar nga administratori i Kolegjit Universitar “Wisdom” ose njësisë kryesore. Komisioni miratohet nga administrator i shoqërisë.
3. Personeli administrativ emërohet nga administratori i shoqërisë, nga lista e përzgjedhur e kandidatëve të komisionit *ad hoc* e propozuar nga administratori i Kolegjit Universitar “Wisdom” ose njësisë kryesore;
4. Kontrata e punës me personelin administrativ nënshkruhet nga administrator i shoqërisë.

#### **Neni 55**

##### **Masat disiplinore**

1. Masa disiplinore për personelin akademik dhe atë ndihmës përcaktohen në kontratën e punës sipas nenit 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë dhe nenet 68 të ligjit për arsimin e lartë:
2. Llojet e masave disiplinore janë:
  - Tërheqje vëmendje
  - Vërejtje me shkrim
  - Vërejtje me paralajmërim
  - Pezullim nga detyra
  - Largim nga puna

3. Masat disiplinore jepen nga autoritetet drejtuese të Kolegjit Universitar “Wisdom”, respektivisht nga Rektori, Dekani, Përgjegjësi i Departamentit. Me përjashtim të masës “largim nga puna” që është kompetencë vetëm e rektorit.
4. Rastet për të cilat merret masa disiplinore përcaktohen në Rregulloren e Kolegjit Universitar “Wisdom” dhe të Këshillit të Etikës.

#### **Neni 56**

##### **Kritere të përgjithshme të punësimit**

1. Personat për punësim të të tre kategorive, personel akademik, personel ndihmësakademik dhe personel administrativ duhet të plotësojnë këto kërkesa të përgjithshme:
  - të jenë shtetas shqiptarë me zotësi të plotë për të vepruar;
  - të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurojnë;
  - të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen veprë penale me dashje;
  - të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.
2. Kriteret e veçanta vendosen në njoftimin e konkurrimit për vendin e lirë të punës mbështetur në pozicionin dhe përshkrimin e punës. Këto kërkesa përcaktohen nga njësitë përkatëse që kërkojnë plotësimin e vendit të lirë të punës.

#### **Neni 57**

##### **Komisioni i Përzgjedhjes**

1. Komisioni i vlerësimit dhe i përzgjedhjes *ad hoc* për personelin akademik përbëhet nga:
  - dekani, kryetar i komisionit;
  - dy përfaqësues të propozuar nga departamenti përkatës dhe të miratuar nga dekani;
  - një përfaqësues i zgjedhur nga rektori.
  - një përfaqësues të zgjedhur nga administrator i shoqërisë;
2. Për personelin administrativ të fakultetit komisioni kryesohet nga administratori i njësisë dhe përbëhet nga dy përfaqësues të zgjedhur përkatësisht një nga dekani dhe një nga administratori i Kolegjit Universitar;
3. Për personelin administrativ të Kolegjit Universitar “Wisdom”, komisioni kryesohet nga Administratori i Kolegjit Universitar dhe përbëhet nga dy përfaqësues të tjerë të caktuar përkatësisht një nga rektori dhe një nga administratori i shoqërisë.
4. Komisionet *ad hoc* miratohen nga rektori i Kolegjit Universitar “Wisdom”.

#### **Neni 58**

##### **Vlerësimi dhe shpallja e fituesit**

1. Komisioni i Vlerësimit dhe Përzgjedhjes *ad hoc* bën renditjen e kandidatëve sipas plotësimit të kërkesave të publikuara që i përgjigjen përshkrimit të vendit të punës dhe performancës.
2. Për personelin akademik, autoriteti drejtues i njësisë kryesore i paraqet për emërim rektorit, kandidatin e renditur i pari në klasifikimin e bërë nga komisioni.

3. Për personelin administrativ dhe ndihmës mësimor-shkencor, administratori i shoqërisë vendos emërimin dhe nënshkruan kontratat e punës.

### **Neni 59**

#### **Koha e provës**

1. Personeli administrativ i punësuar në KU “Wisdom” i nënshtrohet një periudhë prove (jo domosdoshmërisht) e cila mund të jetë 3 (tre) deri në 6 (gjashtë) muaj. Në mbarim të kësaj periudhe, vendoset në se marrëdhënia e punës do të vazhdojë apo do të ndërpritet. Të punësuarit, ndërprerja e marrëdhënies së punës duhet ti arsyetohet.

### **Neni 60**

#### **Përmbajtja e kontratës së punës**

1. Kontratat e punës me personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme nënshkruhen nga rektori i Kolegjit Universitar ”Wisdom”, pasi ka marrë mendimin e administratorit të shoqërisë për punësim. Kontratat e punës me personelin administrativ nënshkruhen nga administratori i shoqërisë.

2. Kontrata e punës duhet të përmbajë:

- identitetin e palëve;
- vendin e punës;
- përshkrimin e punës që do të kryejë individi;
- datën e fillimit;
- kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës;
- kohëzgjatjen e kohës së punës dhe të pushimit;
- pagën;
- normën mësimore (për personelin përkatës).

3. Kontrata e punës nënshkruhet jo më vonë se 30 ditë nga dita e emërimit në punë. Kontrata e punës me personel akademik me kohë të pjesshme do të nënshkruhet për një punë të caktuar ose për një periudhë kohe të caktuar.

### **Neni 61**

#### **Zgjidhja e kontratës së punës**

1. Mbarimi i marrëdhënies së punës bëhet kur punonjësi:

- Jep dorëheqjen;
- Mbush moshën e pensionit;
- Mbaron afati i parashikuar në kontratën e punës;
- Bëhet i paaftë për kryerjen e detyrave për shkaqe fizike dhe mendore;
- Dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës me burgim;
- Konkludohet paaftësi për kryerjen e detyrave;
- Në rastet e ristrukturimit të institucionit, të ndryshimeve apo mbylljeve të njësive;
- Merret masa disiplinore e largimit nga puna.

2. Zgjidhja e kontratës së punës bëhet sipas procedurave të përcaktuara në Kodin e Punës. Punëdhënësi për zgjidhjen e kontratës së punës, pas kohës së marrjes në provë, duhet të njoftojë me shkrim punëmarrësin të paktën 72 orë para takimit dhe të bisedoj me të. Punëdhënësi, gjatë kësaj bisede, i parashtron punëmarrësit arsyet e vendimit të parashikuar për t'u marrë dhe i jep atij mundësi për t'u shprehur.
3. Zgjidhja njoftohet me shkrim, brenda një afati nga 48 orë deri në 7 (shtatë) ditë pas takimit. Kjo procedurë zbatohet edhe në rastet e zgjidhjes së menjëhershme të kontratës.
4. Kontrata me afat të caktuar përfundon në fund të kohës së parashikuar, pa zgjidhje paraprake. Kur, mbas përfundimit të afatit të caktuar, kontrata zgjatet në heshtje tej këtij afati, ajo konsiderohet si kontratë me afat të pacaktuar.

## **KREU V**

### **ORGANIZIMI I STUDIMEVE**

#### **Neni 62**

##### **Programet e studimeve**

1. Kolegji Universitar "Wisdom", aktualisht ofron programe studimi të ciklit të parë dhe ciklit të dytë të studimeve universitare. Këto programe studimi i referohen niveleve 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Për vitin akademik 2017 – 2018, do të ofrohen programe studime të integruara, te ciklit të dytë, në fushën e drejtësisë me kohëzgjatje 5 vjet.
2. Programi i studimit propozohet, hartohet dhe rishikohet me kërkesë të njëjësive baze në përputhje me tregun e punës. Propozimi për hapjen, rishikimin apo mbylljen e një program studimi, në çdo rast vjen i argumentuar. Programet e studimit të akredituara mund të ndryshohen deri në masën 20 për qind. Miratimi i ndryshimeve bëhet nga Senati Akademik dhe për të njoftohet ministria përgjegjëse për arsimin e lartë jo më vonë se gjashtë muaj para fillimit të vitit akademik.
3. Programet e studimeve të ciklit të parë, synojnë të japin njohuri bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një shumëllojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh. Programet e studimeve të ciklit të parë konceptohen në radhë të parë nga departamentet duke respektuar dhe kërkesat e dispozitave ligjore dhe nënligjore. Departamentet hartojnë programe studimore për çdo lëndë që përfshihet në sferën e njësisë bazë. Projekt-programet e përgatitura nga departamentet, shqyrtohen dhe marrin një miratim paraprak në dekanat. Në përfundim të procesit të shqyrtimit të programeve brenda fakultetit, dekani ia dërgon programin për miratim Senatit Akademik. Programet e studimeve të ciklit të parë realizohen si rregull me 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vjet. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë lëshohet diplomë "Bachelor" në fushën e arsimimit të kryer.

4. Rregulla më specifike në lidhje me hartimin e programeve, kuotat e pranimit, kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve, veçoritë akademike, kohëzgjatjen e studimeve, kreditet si dhe diplomat e programeve përcaktohen në rregulloret e fakulteteve dhe të programeve të studimit.

### **Neni 63**

#### **Format e studimit dhe pranimit i studenteve**

1. Forma e studimeve në KU “Wisdom” është studime me kohë të plotë. Programet e studimeve organizohen në module ose lëndë të veçanta, të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS).
2. Pranimet e studentëve në KU “Wisdom” në të gjitha programet e studimit realizohet sipas procedurave të përcaktuara në aktet nënligjore të MAS dhe në rregulloret e KU “Wisdom”, të fakulteteve dhe të programeve të studimit, në përputhje me standardet shtetërore, të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore. Këto standarde verifikohen dhe certifikohen nga ministria përgjegjëse për arsimin, përpara deklarimit të kuotave të pranimit nga të gjitha institucionet e arsimit të lartë.

### **Neni 64**

#### **Kohëzgjatja e studimeve**

1. Kohëzgjatja normale e studimeve në KU “Wisdom” është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Afati normal i studimeve për ciklin e parë të studimeve, “Bachelor” është 3 (tre) vite akademike; për programet e ciklit të dytë, “Master i Shkencave” është 2 (dy) vite akademike. Afati normal i studimeve në programet e integruara të ciklit të dytë në drejtësi është 5 vjet.
2. Kohëzgjatja maksimale për çdo program studimi është jo më shumë se sa dyfishi i kohës normale të studimeve. Në këtë afat nuk futet periudha e kohës kur student i ka pezulluar studimet, sipas përcaktimeve në rregulloret e programeve të studimeve.
3. Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër. Ai u nënshtrohet kriterëve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të Kolegji Universitar “Wisdom”. Kreditet e grumbulluara nga student i gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, me vendim të komisionit *ad hoc* të ngritura pranë njësive bazë.

### **Neni 65**

#### **Kuotat e pranimit në programet e studimit**

1. Senati Akademik i Kolegji Universitar “Wisdom” miraton propozimet e bëra nga njësitet bazë për kuotat e pranimit në çdo program studimi, bazuar në infrastrukturë dhe kapacitetet akademike.
2. Në formulimin e propozimit për kuotat e pranimit, dekani paraqet argumente që lidhen me misionin e programit të studimit, hapësirën fizike dhe disponueshmëria e stafit akademik dhe atij mbështetës duke vënë theksin tek raporti pedagog-student (referenca bëhet tek numri i propozuar

i studentëve), raporti i pedagogeve të brendshëm me ata të jashtëm, niveli i kualifikimit shkencor të stafit akademik, disponueshmëria e mjeteve didaktike dhe burimeve të literaturës në funksion të metodave të mësimdhënies, etj..

#### **Neni 66**

##### **Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve**

1. Kriteret e pranimit në çdo program studimi miratohen nga Senati Akademik i KU "Wisdom". Krahas propozimit të justifikuar për kuotat e pranimit, secili departament përgatit edhe propozimin për kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. Këto kritere bëhen publikisht të njohura nga KU "Wisdom".
2. Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni i domosdoshëm për pranimin dhe regjistrimin e studentëve përcaktohen në rregulloren e Kolegji Universitar dhe të programeve të studimit, në përputhje me aktet nënligjore të MAS.

#### **Neni 67**

##### **Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies**

1. Studimet në KU "Wisdom" zhvillohen me bazë vitin akademik i cili organizohet në semestra. Çdo semestër ka 15 javë, me së paku 20 orë mësimore (leksione, seminare, ushtrime e laboratorë) dhe jo më shumë se 25 orë mësimore në javë.
2. Organizimi i procesit mësimor, frekuentimi i veprimtarive mësimore, seminare, ushtrime, praktika, kalimi në vitin pasardhës, përcaktohen në rregulloren e KU "Wisdom".

#### **Neni 68**

##### **Ndjekja e një programi të dytë studimi**

1. Personat që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi. Në këtë rast pranohen për aplikim, si rregull kandidatët me diplomë të përafërt me programin e dytë në të cilin kërkojnë të studiojnë.
2. Kriteret specifike për t'u pranuar në një program të dytë studimi përcaktohen në rregulloret e Kolegjit Universitar „Wisdom” dhe të programeve të studimit.

#### **Neni 69**

##### **Transferimet dhe Ekuivalentimet**

1. KU "Wisdom" ofron mundësi për transferime të studentëve midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda vetë institucionit apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, si dhe për transferime nga programet e mëparshme në programe të studimeve të ciklit të parë.
2. Transferimet kryhen në fillim të çdo viti akademik. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve, i takon komisionit përkatës, të ngritur pranë departamenteve të Kolegjit Universitar "Wisdom".
3. Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e Kolegjit Universitar dhe të njësive bazë, në përputhje me kërkesat ligjore.



## **Neni 70**

### **Pajisja me diplomë**

1. Me përfundimin e studimeve universitare në KU “Wisdom”, fitohen këto diploma:
  - a) Diplomë e ciklit të parë “Bachelor”;
  - b) Diplomë e ciklit të dytë “Master i Shkencave”;
  - c) Diplomë e integruar e ciklit të dytë.
2. Çdo formë diplome dhe certificate, përpara se të lëshohet, miratohet në Senatin Akademik dhe regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe regjistrin shtetëror të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve të Arsimit.

## **Neni 71**

### **Statusi i studentit**

1. Studenti e fiton statusin juridik “Student i Kolegjit Universitar “Wisdom” me regjistrimin e tij në programin e studimit dhe me nënshkrimin e kontratës. Studenti e humbet këtë status me marrjen e diplomës, si dhe në rast të çregjistrimit të tij. Studenti çregjistrohet me kërkesën e tij me shkrim. Rastet e çregjistrimit të studentit përcaktohen në rregulloren e Kolegjit Universitar dhe të programeve të studimit.
2. Të dhënat personale të çdo studenti, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën bashkë me suplementin e diplomës, etj., mbahen në regjistrin bazë të studentëve. Ky regjistër plotësohet në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbahet në ruajtje të përhershme.
3. Çdo studenti, në regjistrimin fillestar në KU “Wisdom”, i jepet një numër unik matrikullimi, që e shoqëron deri në marrjen e diplomës ose certifikatës, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Ministri i Arsimit dhe Sportit për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit.
4. Studenti mund t’i pezullojë studimet dhe t’i rifillojë ato, në përputhje me rregullat e përcaktuara në rregulloren e Kolegjit Universitar dhe të programeve të studimit. Studenti nuk mund të regjistrohet, njëkohësisht, në më shumë se një program studimi të të njëjtit cikël bëjnë përjashtim studentët e eksellencës.

## **Neni 72**

### **Të drejtat dhe detyrimet e studentëve**

1. Studentët kanë të drejtë:
  - a) të ndjekin të gjitha veprimtaritë mësimore që zhvillohen në kuadrin e programit të studimit ku ata janë regjistruar;
  - b) të përdorin infrastrukturën, që KU “Wisdom” vë në dispozicion të procesit mësimor, si dhe të përfitojnë nga shërbimet mbështetëse që ofrohen nga KU;
  - c) të zgjedhin dhe të zgjidhen në Këshillin e Studentëve dhe organet e institucionit, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe këtë Statut;

- d) të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes së Kolegjit Universitar;
- e) të shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit në KU “Wisdom, nëpërmjet anketimeve dhe formave të tjera demokratike;
- f) të nënshkruajnë kontratë shërbimi, në momentin e regjistrimit në KU “Wisdom”, sipas standartit të parashikuar në udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin;
- g) të transferojnë kreditet/studimet nga institucione të tjera të arsimit të lartë në KU “Wisdom” dhe anasjelltas;
- h) të organizohen lirisht në grupime me karakter social, ekonomik, kulturor, sportiv dhe akademik;
- i) të sigurohen nga KU “Wisdom” në një ndër shoqëritë e sigurimit, për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar të studimeve, për riskun e ndërprerjes së veprimtarisë apo risqe të tjera, sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit të financave.
- j) të pajisen me Kartën e Studentit, e cila është dokument unik.
- k) të kërkojë ndihmë a këshillim nga organet kompetente të Kolegjit Universitar për njohjen e rregullave dhe të mundësive që ofron për studime, specializime dhe kualifikime;
- l) të njihet me rezultatet e arritura prej tij dhe të kërkojë këshillim për zgjedhjen që duhet të bëjë për të fituar një diplomë të caktuar a specializimin e dëshiruar;
- m) të mos lejojë të bëhen të njohura të dhënat e tij vetjake dhe përfundimet e tij gjatë viteve të studimit;
- n) të ankohet në mënyrë individuale ose kolektive, kur gjykon se procesi mësimor nuk zhvillohet në mënyrë të rregullt, kur njohuritë e ofruara nuk u përgjigjen kërkesave a nivelit të premtuar;
- o) të bëjë kërkesë dhe ankesë kur mendon se vlerësimi për të nuk është i drejtë;
- p) të dëgjohet nga organet përkatëse të Kolegjit Universitar, përpara se të merret masë ndëshkimore kundër tij dhe kërkojë rishikimin e masës së dënimit të dhënë ndaj tij.

## 2. Studentët kanë detyrë:

- a) të zbatojnë rregullat e përcaktuara nga KU “Wisdom”
- b) të ndjekin rregullisht procesin mësimor, seminarët, leksionet dhe orët e tjera mësimore që janë të detyrueshme sipas programit të studimit;
- c) të kushtojnë vëmendjen e duhur studimeve dhe të marrin pjesë në veprimtaritë akademike;
- d) të respektojnë të drejtat e personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe të studentëve të tjerë;
- e) të paguajnë tarifën e përcaktuara nga KU “Wisdom”, sipas kontratës së nënshkruar, si dhe tarifën e shërbimeve që u ofrojnë ky institucion i arsimit të lartë;
- f) të shlyejë të gjitha detyrimet e përcaktuara në planin mësimor dhe në programet e lëndëve për të bërë të mundur fitimin e krediteve të nevojshme;
- g) të respektojnë Kodin e Etikës së Kolegjit Universitar “Wisdom”;

### **Neni 73**

#### **Këshilli i Studentëve**

1. Në KU “Wisdom”, studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentorë në nivel njësie kryesore.
2. Këshilli i Studentëve është organizim i pavarur i studentëve të Kolegjit Universitar, i cili nuk zhvillon veprimtari politike dhe ekonomike. Këshilli realizon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të Kolegjit Universitar “Wisdom”, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve.
3. Këshilli i studentëve zgjidhet çdo 2 (dy) vjet nga votat e studentëve, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, me një rregullore të veçantë të propozuar nga vetë studentët dhe të miratuar nga Senati Akademik, e cila i bashkëlidhet rregullores së KU “Wisdom” dhe mbështetet në legjisllacionin në fuqi.
4. Këshilli i studentëve nuk mund të organizohet me struktura të tjera politike e jopolitike, jashtë Kolegjit Universitar “Wisdom”.
5. Këshilli i studentëve shpreh mendime dhe propozime për probleme me interes të përgjithshëm të Kolegjit Universitar, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtari të mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj.
6. KU “Wisdom”, e mbështet Këshillin e Studentëve nga ana logjistike dhe mund të financojë projekte të tyre, përmes miratimit të një fondi vjetor.

### **Neni 74**

#### **Bursat e studimeve**

1. KU “Wisdom”, ofron disa lloje bursash studimi si mbështetje ekonomike për kategori të caktuara sociale, si dhe bursa me kriter ekselencën për studentët e shkëlqyer.
2. Bursa e studimit mund të jetë e plotë ose e pjesshme. Kushtet e gëzimit të bursës së ofruar përcaktohen në kontratën përkatëse që studenti lidh me KU “Wisdom”.
3. Bursat akordohen nga një komision *ad hoc*, Komisioni për Akordimin e Bursave, i cili ngrihet nga Administratori i Shoqërisë.
4. Kriteret dhe procedurat e akordimit të bursave përcaktohen nga Bordi i Administrimit me rregullore të veçantë.

### **Neni 75**

#### **Kontrolli dhe Vlerësimi i Dijes**

Çështjet që kanë të bëjnë me sistemin e notave dhe të vlerësimit të dijes, format e kontrollit të dijes, si dhe organizimi dhe zhvillimi i provimeve dhe riprovimeve përcaktohen në Rregulloren e Kolegjit Universitar “Wisdom” dhe të programeve të studimit.

### **Neni 76**

#### **Dokumentacioni i procesit mësimor**

1. KU “Wisdom” mbanë në formë të shkruar:

- a) regjistrin themeltar të studentëve;
- b) regjistrin e arritjeve akademike;
- c) regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.

2. Regjistri themeltar i studentëve është dokumenti që vërteton regjistrimin e studentëve. Çdo student pajiset me një numër unik matrikullimi, që e mban deri në marrjen e diplomës ose certifikatës, i cili pasqyrohet në këtë regjistër. Regjistri themeltar depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së Kolegjit Universitar. Ai plotësohet edhe në formë elektronike.

3. Regjistri i arritjeve akademike është dokumenti që vërteton rezultatet e arritura nga çdo student i regjistruar në institucionin e arsimit të lartë, sipas programeve të studimit. Regjistri i arritjeve akademike depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së Kolegjit Universitar. Ai plotësohet edhe në formë elektronike.

4. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave është dokumenti që vërteton emetimin e tyre prej Kolegjit Universitar “Wisdom”, e cila dokumenton tërheqjen e diplomës dhe suplementin të diplomës prej secilit student që ka përfunduar me sukses detyrimet akademike dhe ato të tjera institucionale.

5. KU “Wisdom” plotëson elementet e regjistrave, në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së Kolegjit Universitar. Ai plotësohet edhe në formë elektronike.

6. Dokumentacioni, pas plotësimit përfundimtar të tij, depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet në arkivin e institucionit të arsimit të lartë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloren e Kolegjit Universitar dhe rregulloren e sekretarisë. Në rastin e mbylljes së veprimtarisë së Kolegjit Universitar “Wisdom”, regjistrat e tij, sipas përcaktimeve në pikën 1, të këtij neni, dhe çdo dokument tjetër, depozitohen në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat.

## **Neni 77**

### **Baza e të dhënave për studentët**

KU “Wisdom” ruan të dhënat personale të studentëve. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve kryhen, bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

## **KREU VI KËRKIMI SHKENCOR**

## **Neni 78**

### **Veprimtaria kërkimore shkencore**

1. KU “Wisdom” kryen veprimtari kërkimore-shkencore bazë ose të zbatuar, studime, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese, sipas natyrës dhe objektivave specifike të saj. Veprimtaritë e kërkimit shkencor realizohen mbi bazën e programeve dhe projekteve të miratuara nga Senati Akademik dhe Bordet përkatëse.
2. Veprimtaria kërkimore-shkencore, që kryhet në KU “Wisdom” synon të mbështesë zhvillimin e vendit dhe rritjen e cilësisë së arsimit.
3. Nëpërmjet veprimtarisë kërkimore-shkencore personeli akademik i Kolegjit Universitar “Wisdom” dhe studentët fitojnë aftësi për kërkime të pavarura, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm profesional dhe të karrierës akademike.

## **Neni 79**

### **Struktura e kërkimit shkencor në Kolegjin Universitar “Wisdom”**

1. Veprimtaria kërkimore-shkencore pranë Kolegjit Universitar “Wisdom” zhvillohet në njësitë bazë.
2. Njësitë bazë të Kolegjit Universitar “Wisdom” zhvillojnë veprimtaritë e tyre në përputhje me misionin dhe fushat e kompetencës dhe u nënshtrohen kriterëve të financimit të veprimtarisë së tyre kërkimore-shkencore, sipas ligjit për Arsimin e Lartë dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ato kanë detyrimin të bëjnë publike veprimtarinë e tyre, si edhe rezultatet përkatëse, në revistat shkencore periodike, botime shkencore, etj.. Ato garantojnë integrimin e veprimtarisë kërkimore në atë të mësimdhënies. Kërkimi shkencor bazë është veprimtaria kërkimore-shkencore, që ka për qëllim kryesor zgjerimin, thellimin, ri konceptimin dhe ri integrimin e njohurive shkencore mbi fenomenet e studiuara dhe të kuptuarit teorik të ndërveprimit midis aktorëve të ndryshëm dhe vetë procesit ku ato ndikojnë. Kërkimi shkencor i zbatuar është veprimtaria kërkimore-shkencore, që ka për qëllim të gjejë zgjidhje praktike dhe specifike me objektiv kryesor shfrytëzimin e njohurive teorike, me qëllim zbatimin e tyre në praktikë.
3. Fushat, drejtimet, vëllimi i punës dhe afatet e veprimtarisë kërkimore-shkencore përcaktohen nga vetë institucionet e arsimit të lartë, bazuar në fushat prioritare të zhvillimit kombëtar dhe në programet e ofruara nga KU “Wisdom”. Veprimtaria kërkimore-shkencore e personelit akademik vlerësohet në fund të çdo viti akademik.

## **KREU VII**

### **DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

## **Neni 80**

### **Vula Zyrtare**

Kolegji Universitar “Wisdom” ka vulën zyrtare ku shkruhet; *Republika e Shqipërisë, (Tiranë në fund) Kolegji Universitar Wisdom –(Wisdom lart )*, në mes pishtar me ngjyrat e flamurit Italian

(jeshile, e bardhe, e kuqe) dhe element të tjerë, sipas shtojcës nr.1, bashkëlidhur këtij statuti, e cila është pjesë përbërëse e Statutit të KU“Wisdom”.

#### **Neni 81**

##### **Logo e KU “Wisdom”**

Kolegji Universitar “Wisdom” ka logon e tij, ku shkruhet; *Kolegji Universitar Wisdom – (Wisdom lart )*, në mes pishtar me ngjyrat flamurit Italian (*jeshile, e bardhe, e kuqe*) dhe element të tjerë të Logos, sipas shtojcës nr.2, bashkëlidhur këtij statuti, e cila është pjesë përbërëse e Statutit të KU “Wisdom”.<sup>2</sup>

#### **Neni 82**

Studentët e programit të studimit, të ciklit të parë në “Drejtësi”, të cilën kanë nisur studimet në vitin akademik 2016-2017 dhe në vitet akademike të më përparshme do të vazhdojnë studimit sipas kriterëve dhe modaliteteve të legjislacionit të kohës kur këta studentë janë pranuar.

#### **Neni 83**

Mbështetur në këtë Statut, KU “Wisdom” nxjerr rregulloren e tij dhe rregullore të tjera, sipas njesive të strukturave akademike dhe administrative, si dhe programeve të studimit.

#### **Neni 84**

Ky Statut mund të ndryshohet në përputhje me kërkesat ligjore, nga senati akademik dhe bordi i administrimit me miratim të ministrit përgjegjës për arsimit.

#### **Neni 85**

Ky Statut u miratua paraprakisht nga Bordi i Administrimit me Vendimin nr.4, datë 31.01.2017 dhe Senati Akademik me Vendimin Nr.7, datë 03.02.2017.

#### **Rektori**

**Prof. Dr. Lush PERPALI**

---

<sup>2</sup> Ndryshuar me Urdhër Nr.459, date 22.11.2021 “Për miratim e disa ndryshimeve ne Statutitn e Kolegjit Universitar “Wisdom”